



Prot 6597



Dt. 31.08.2017



KONTRATA E KONCESIONIT
“PËR NDËRTIM LANDFILLI, INCENERATORI DHE
REHABILITIM I VENDDEPOZITIMEVE EKZISTUESE
TIRANËDHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”
ZONA E TRAJTIMIT TE MBETJEVE TIRANË (ZTWT)

NDËRMJET:

MINISTRISË SË MJEDISIT

DHE

SHOQËRISË “INTEGRATED ENERGY BV SPV” SHPK.”

TIRANË, GUSHT 2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. REP. 6021

NR. KOL. 2005

KONTRATË KONCESIONI


Kjo Kontratë Koncesioni ("Kontrata") lidhet sot më datë 31.06.2014, mes palëve të mëposhtme, përpara meje noterit [signature], anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë mes palëve të mëposhtme:

Ministria e Mjedisit, me adresë Blv Zhan D'Ark, no. 27, Tiranë, përfaqësuar nga Ministri Z. Lefter Koka, identifikuar me kartë identiteti [signature], referuar këtu e në vijim si "**AUTORITETI KONTRAKTUES**"; DHE

Shoqërisë Koncesionare "Integrated Energy BV SPV" Shpk, me adresë në [Tiranë, Rr. Dervish Hima, H. 1, 71/1, dhe me NIPT L72031013B, përfaqësuar nga Z. Giuseppe Ciaffaglione, referuar këtu e në vijim si "**KONCESIONARI**".

Për sa u parashtrua më sipër, Palët e sipërpërmendura, me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord për sa më poshtë:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME



1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 *Perkufizime:*

"Afat (i Kontratës)" ose "Kohëzgjatje (e Kontratës)" është periudha që fillon, në Ditën Efektive të kësaj Kontrate dhe përfundon në përfundim të Periudhës së Koncesionit, apo në një datë të mëvonshme, e caktuar në marrëveshje mes Palëve, ose si pasojë e një shtyrje konform dispozitave të kësaj Kontrate.

"Aneks" është çdo shtojcë, deklaratë, vërtetim, autorizim, vendim, urdhër ose dokument tjetër i nënshkruar nga palët që i bashkëlidhet kësaj Kontrate, si pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj, tani apo në të ardhmen.

"Anekset"

- Aneksi I Dokumentat Standarte të Procedurës Përzgjedhëse Konkuruuese
- Aneksi II Oferta e Koncesionarit
- Aneksi III Plan-Biznesi dhe studimet fizibilitetit (teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor)
- Aneksi IV Grafiku i Punimeve
- Aneksi V Sigurimi i Kontratës
- Aneksi VI Karakteristikat e Impiantit të Përpunimit të Mbetjeve
- Aneksi VII Plani dhe Koordinatat e Shesheve
- Aneksi VIII Projekti Teknik (Përshkrim)
- Aneksi IX Forma e Angazhimit mbi detyrimet e Njesive Vendore të Qarkut Tiranë



"Autoriteti Kontraktues" është Ministria e Mjedisit (M.M) e Republikës së Shqipërisë, ose çdo Entitet Shtetëror tjetër që ushtron kompetencat në fushën e Mbetjeve Urbane dhe interurbane dhe përpunimit të tyre (zbatimit të kësaj Kontrate).

"Autorizim" do të thotë çdo pëlqim, leje, licencë, miratim, çertifikatë apo akt i një organi shtetëror, lëshimi apo rinovimi e të cilit është përgjegjësi e organeve shtetërore, i nevojshëm për ekzekutimin e kësaj Kontrate, zbatimin e Projektit, përpunimin e mbetjeve urbane, ndërtimin dhe funksionimin e Impianteve, shitjen e



prodhimit dhe nxjerrjene fitimeve nga ky aktivitet, ose pagimin e ndonjë detyrimi për shërbimet përfshirë, por pa u kufizuar në to, të gjitha lejet e nevojshme në lidhje me:

- a) sheshet dhe gëzimin e qete të tyre;
- b) mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe miratimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis nga Ministria e Mjedisit;
- c) të drejtat e përpunimit të Mbetjeve;

"Bashkia Tiranë" është njësi vendore e Qarkut Tiranë, në përputhje me ndarjen administrative dhe territoriale në fuqi, në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

"Çertifikata Përfundimtare" ose "Çertifikata e Përfundimit të Punimeve për Realizimin e Projektit" është vërtetimi që lëshohet nga Autoriteti Kontraktues ose çdo Entitet Shtetëror Kompetent në lidhje me përfundimin e ndërtimit të Veprave nga Koncesionari.

"Çmim për Ton Mbetje Urbane" është çmimi prej 29 EUR (njëzet e nëntë Euro) për ton mbetje, pa TVSH, i pagueshëm nga Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë në favor të Koncesionarit.

"Data Efektive" do të jetë data e nënshkrimit të kësaj Kontrate..

"Data e Fillimit të Punimeve" do të jetë dita kur (i) Koncesionari do të jetë pajisur me Lejen Zhvillimore, dhe me të gjitha, Autorizimet, Lejet dhe Licencat, të nevojshme (ii) do të ketë marrë në dorëzim, pa asnjë defekt apo të metë, të gjitha Sheshet, pasuritë apo asetet, mbi të cilat do të realizohet Projekti; (iii) Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë, ose në diskrecion të Koncesionarit, të paktën Bashkia Tiranë, do të kenë firmosur dhe miratuar në mënyrë të rregullt Formën e Angazhimit mbi detyrimet e njesive vendore të Qarkut Tirane, dhe Koncesionari do të jetë i gatshëm të fillojë zbatimin e këtij Projekti.

"Data e Përfundimit të Punimeve" është data në të cilën do të përfundojë ndërtimi i të gjithave dhe çdo Vepre, dhe dita në të cilën do të lëshohet Çertifikata Përfundimtare, ose kjo e fundit do të konsiderohet të jetë lëshuar, sipas dispozitave të kësaj Kontrate.

"Dokumente Financimi" është çdo marrëveshje huaje, notë premtuese, obligacion, marrëveshje sigurimi apo titujsh, hipotekat, trustet, marrëveshjet e kredive, nota ose marrëveshjet për blerje obligacionesh, marrëveshje pjesëmarrjeje dhe çdo dokument tjetër në lidhje me financimin, projektimin, prokurimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Impianteve dhe Veprave, përfshirë marrëveshjet e blerjes së

energjisë elektrike dhe për ushtrimin e të drejtave të koncesionit, përfshirë çdo ndryshim, shtesë, zgjatje kohore dhe zëvendësim për financime të tilla.



"Dorëzimi i Venddepozitimit Ekzistues" do të jetë dorëzimi nëpërmjet një procesverballi i Venddepozitimit Ekzistues tek Koncesionari nga Bashkia Tiranë, i nënshkruar gjithashtu nga Autoriteti Kontraktues, ku Bashkia Tirane si Njësi Vendore e Qarkut Tiranë ia dorezon Koncesionarit me qëllim Operimin e tij të menjëhershëm dhe kryerjen e shërbimit të marrjes së Mbetjeve nga Koncesionari dhe depozitimit të tyre, menjëherë dhe jo më vonë se 30 ditë pas Datës Efektive të kësaj Kontrate.

"E drejta ekskluzive (e Koncesionarit)" është e drejta Koncesionarit për tu furnizuar, dhe për perpunimin dhe selektimin e Mbetjeve Urbane ekzistuese dhe të ardhshme, të sjella bruto, siç janë grumbulluar në origjinë, të papërpunuara, të mbledhura në territorin e Qarkut Tiranë nga të gjitha Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë, nëpërmjet ndërrmarrjeve të veta ose të tretëve të kontraktuar prej tyre.

"E drejta për kalim" është e drejta për të kaluar mbi dhe nën Shesh(e), dhe në çdo pjesë të tij, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në të, me qëllim zbatimin e kësaj kontrate.

"Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE)" është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike që vepron sipas Ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike".

"Entitet Shtetëror" do të thotë (i) Republika e Shqipërisë; (ii) çdo ministri, drejtori, apo departament; ose çdo organizatë / ent publik, autoritet / organ shtetëror / publik ose çdo ent, shoqëri tregtare nën kontroll shtetëror, apo agjensi, e cila vepron apo operon për llogari dhe në përfitim të Shtetit Shqiptar / Republikës së Shqipërisë; apo (iii) çdo gjykatë nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë; apo (iv) çdo entitet rregullator i pavarur në Republikën e Shqipërisë, që vepron sipas Ligjit.

"Energjia elektrike" është energjia elektrike e prodhuar nga Impianti i Përpunimit të Mbetjeve pjesë e Objektivit të Koncesionit, i matur në njësitë kilovatore (KWh).

"Faza e Ndërtimit" do të jetë periudha nga Data e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit deri Datën e Përfundimit të Punimeve të ndërtimit të Objektivit të Kontratës.

"Force Madhore" ose "Ngjarje e Forces Madhore" ka kuptimin e përcaktuar në nenin 17.1.1. këtu me poshte në këtë Kontratë.

"Force Madhore e Tejzgjatur" do të thotë Force Madhore e cila ka zgjatur jo më pak se 60 ditë.



"Gëzim i Qetë" do të thotë e drejta ekskluzive për të zënë, përdorur dhe gëzuar Sheshin/et (duke përfshirë objektet ekzistuese), të përcaktuara në hartat/planet perkatëse dhe të drejtën për kalim, gjatë afatit, në përputhje me këtë Kontratë, pa ndërhyrje të pajustificuar nga Autoriteti Kontraktues ose nga ndonjë Enitet Shtetëror.

"Grafiku i Punimeve" është kalendari i detajuar i punimeve për t'u realizuar nga Koncesionari, bashkëlidhur kësaj Kontrate si Aneksi IV i saj, ku për hir të qartësisë, dita e parë e të cilit do të jetë Data e Fillimit të Punimeve.

"Humbje Direkte" do të thotë:

- a) për Koncesionarin:
 - i) çdo humbje e të ardhurave, ose dëm tjetër efektiv dhe/ose çdo kosto shtesë e shkaktuar si rezultat i shkeljes ose mospërbushjes së detyrimeve të kësaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktues ose nga Veprimi Shtetëror Thelbësisht në kundërshtim me Kontraten; dhe
 - ii) çdo humbje apo dëm i pësuar nga Koncesionari si rezultat i dëmtimeve të pronës apo dëmtimeve të tjera;
- b) për Autoritetin Kontraktues: çdo humbje ose dëm i pësuar si rezultat i dëmtimit të pronës apo humbje e të ardhurave.

"Impiante" do të përfshijë bashkarisht dhe pa u kufizuar tek ky perkufizim Impiantin e Përpunimit të Mbetjeve / Inceneratorin, Impiantin e Përpunimit të Ujrave të Ndotur, Impiantin e Diferencimit të Mbetjeve dhe çdo impiant tjetër, pjesë e Projektit.

"Impianti i Diferencimit të Mbetjeve" është impianti, i cili do të realizojë diferencimin e mbetjeve dhe gjenerimin e mbetjeve me fuqi kalorike primare për Impiantin e Përpunimit të Mbetjeve, në përputhje me Aneksin VIII të kësaj Kontrate, dhe identifikuar si Lot D i Projektit.

"Impiant i Përpunimit të Mbetjeve" ose "Inceneratori" do të jetë impianti i termovalorizatorit mbetje në energji, i cili do të jetë i përbërë nga 4 linja përpunimi të ndara, në përputhje me Aneksin VI të kësaj Kontrate, dhe identifikuar si Lot C i Projektit.

"Impianti i Përpunimit të Ujrave të Ndotur" do të jetë impianti për trajtimin e ujrave të ndotura, me kapacitet prej 400 m³/ditë, që do të shërbejë për përpunimin e rrjedhave/ujërave të ndotura nga Venddepozitimi Ekzistues dhe nga Venddepozitimet e reja, në përputhje me Aneksin VIII të kësaj Kontrate, dhe identifikuar si Lot E i Projektit.



"Institucionet Financiare" apo "Huadhënësit" janë bankat e licensuara në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj, si dhe çdo organizatë, shoqëri, që do të përzgjidhet për të financuar Projektin, apo kapitalin e Koncesionarit me qëllim kryerjen e Investimit dhe/ose mbështetjen për kapitalin e Koncesionarit, përfshirë Palët Financuese, ashtu sic definohen këtu.

"Kapsulimi i Venddepozitimit Ekzistues" do të jetë procesi i kapsulimit të landfillit ekzistues të Sharrës, dhe do të përbëjë Lotin A të Projektit dhe do të thotë procesi i mbylljes së këtij landfilli, i cili përfshin mbulimin përfundimtar të landfillit me dhé, dhe shtresë të punueshme për të garantuar vegjetacion / bimësi, në përputhje me Aneksin VIII të kësaj Kontrate.

"Koncesionari" është Shoqëria e zbatimit të Projektit "Integrated Energy BV SPV" Sh.p.k..

"Kontratat" janë të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari, me sipërmarrës ose nënkontraktorë për realizimin e Punimeve ose çdo marrëveshje tjetër e lidhur me të tretët që ka si objekt apo shërben si mjet për të bërë të mundur realizimin e Objektivit të Kontratës dhe/ose sigurimin e fondeve financiare, sipas Ligjit në fuqi.

"Kontrata e Koncesionit" është kjo Kontratë, anekset dhe çdo dokument tjetër që bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj.

"Kostot Aktuale të Investimeve" përfshijnë kostot totale të investimeve të kryera nga Koncesionari për zbatimin e Projektit deri në datën e përfundimit të punimeve sipas Planbiznesit dhe studimit të fizibilitetit referuar Aneksit III.

"Kostot Totale të Investimeve" janë të gjitha kostot dhe shpenzimet e paguara ose të pagueshme nga Koncesionari nga lidhja e Kontrates deri në transferimin përfundimtar tek Autoriteti Kontraktues, në përfundim të Afatit të Kontratës.

"Leje"/"Licenca" janë akte administrative, që lëshohen nga Entitetet përkatëse Shtetërore për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarive nga Koncesionari nën Projekt, sipas objektivit të kësaj Kontrate, bazuar në legjisllacionin në fuqi.

"Leje Zhvillimore" do të jetë leja/autorizimi i organit kompetent në Republikën e Shqipërisë në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, për rehabilitimin, zhvillimin dhe/ose ndërtimin e të gjithë

Veprave dhe Impianteve të Projektit në tërësi dhe në çdo fazë, Modul apo Loti të tij, ashtu siç përcaktohet në Projekt dhe/ose Studimin e Fizibilitetit.



“Ligj” përfshin Kushtetutën, Marrëveshjet Ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, ligjet, aktet normative me fuqinë e ligjit, vendimet e Këshillit të Ministrave, aktet nënligjore normative të Ministrave ose Institucioneve të tjera Qendrore, aktet e Organeve të Pushtetit Vendor, dhe çdo akt tjetër normativ apo individual me fuqi juridike, si rregullore, udhëzim, urdhër, licencë, leje, autorizim ose çdo akt tjetër i miratuar dhe i shpallur nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë, vendime gjyqësore që kanë karakter unifikues, akte zyrtare të lëshuara nga çdo organ qendror dhe/ose vendor, që janë në fuqi apo ndryshojnë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje.

“Ligji për Koncesionet” është Ligji Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar.

“Lot(e)” do t’i referohet fazave dhe loteve për çdo vepër të Projektit, të përcaktuara dhe referuara në Grafikon e Punimeve, bashkëlidhur kësaj Kontrate, si Aneksi IV i saj, apo në Projektin e Zbatimit të paraqitur nga Koncesionari.

“Mbetje” do të përfshijë të gjitha Mbetjet Inerte, Mbetjet Urbane dhe Mbetjet e llojeve të tjera, të cilat do të depozitohen në Venddepozitimet që do të operohen nga Koncesionari, konform kësaj Kontrate.

“Mbetje Inerte” ka kuptimin e të gjitha mbetjeve inerte referuar legjislacionit në fuqi në momentin e lidhjes së kësaj Kontrate, apo përgjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, për mbetjet që mbledhen në të gjitha Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë nga një ose disa operatorë ekonomikë privatë apo publikë, të përzgjedhura ose jo këto nga Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë dhe që paketohen dhe transportohen për në Impiante dhe/ose Venddepozitimet sipas Projektit, siç janë mbledhur në burim nga këta operatorë.

“Mbetje të llojeve të tjera” do të thotë çdo mbetje tjetër, përfshirë por pa u kufizuar në mbetje industriale, të cilat mund të perbejnë objekt perpunimi në Impiantet sipas kësaj Kontrate, referuar përkufizimeve të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

“Mbetje Urbane” ka kuptimin e të gjitha mbetjeve urbane referuar legjislacionit në fuqi në momentin e lidhjes së kësaj Kontrate, apo përgjatë Kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, për mbetjet që mbledhen në të gjitha Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë.



"Modul(e)" janë parcela të rethura me argjinaturë ku secila parcelë do të quhet modul. Çdo modul do të mundësojë depozitimin e mbetjeve në mënyrë të pavarur nga moduli tjetër. Tërësia e moduleve krijon një njësi të plotë e cila quhet Venddepozitim.

"Ndërtimi" përfshin ndërtimin / realizimin e Veprave, Objekt të Kontratës referuar Projektit të paraqitur nga Koncesionari në procedurën konkurruese, apo ashtu sic mund të amendohet në Projektin e Zbatimit, apo përgjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.

"Ndotje Ekzistuese e Mjedisit" është çdo ndotje mjedisore ekzistuese pranë dhe në Venddepozitimin Ekzistues dhe brenda Shesheve, dhe dëmeve përfshirë ato pasurore të lidhura më të, përfshirë dëmtimin e tokës, ujit, dherave, ujërave të nëndheshëm dhe ajrit, pavarësisht nëse dëmi ka ardhur përpara ose pas Datës Efektive.

"Nënstacioni Elektrik" është nënstationi elektrik që do të ndërtohet nga Koncesionari sipas kësaj Kontrate, si LOT I, sipas Projektit.


"Njësia e Zbatimit të Projekteve"(NJZP) është njësia e ngarkuar nga Autoriteti Kontraktor për monitorimin e realizimit të Kontrates e përbërë nga 5 anëtarë nga të cilët, dy përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, një përfaqësues të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, dy përfaqësues të Bashkisë Tiranë.

"Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë" janë institucionet e pushtetit vendor / bashkitë, pjesë e Qarkut Tiranë, përgjegjëse për mbledhjen dhe/ose transportimin e mbetjeve urbane në Qarkun Tiranë, ku përfshihen individualisht dhe/ose bashkarisht: Bashkia Tiranë, Bashkia Kavajë, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Kamëz dhe Bashkia Vofshë.

"Objekti" i kësaj Kontrate është: ndërtimi i landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë, shfrytëzimi i tyre dhe produkteve që do të përfitohen si pasojë e vënies së tyre në operim, si dhe prodhimi i energjisë elektrike dhe transferimi i tyre nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues pas periudhës së përcaktuar në dispozitat përkatëse të kësaj Kontrate.

"Oferta" është oferta e paraqitur nga ofertuesi i suksesshëm në procedurën konkurruese, realizuar nga Ministria e Mjedisit objekt sipas kësaj Kontrate.

"Operimi" përfshin të gjitha veprimet e Koncesionarit për shfrytëzimin e të gjithë Impianteve dhe Veprave ose Veprave të tjera Plotësuese sipas Projektit dhe sipas kësaj Kontrate dhe depozitimin, përpunimin e Mbetjeve, prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjisë elektrike, dhe të



gjithë produktet e perftuara nga proceset teknologjike sipas Projektit, apo veprimtari të tjera në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

"Palë" ose "Palët" është njera nga palët ose të gjitha palët e kësaj Kontrate.

"Palë Financuese" është çdo person apo persona që sigurojnë financimin ose rifinancimin sipas Dokumenteve të Financimit të Koncesionarit me qëllim prokurimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Impianteve dhe Veprave dhe për ushtrimin e të drejtave të koncesionit, si dhe trashgimtarët dhe të emëruarit prej tyre, duke përfshirë çdo agjent të personit ose personave, përfshirë aksionerët apo filiale të aksionerëve në lidhje me borxhet, përjashtuar borxhet që përbejnë kapitalin e shoqërisë.

"Pagesa" janë të gjitha pagesat që Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë do të kryejnë në favor të Koncesionarit, për çdo ton mbetje që Koncesionari do të marrë nga këto njësi apo operatorët privatë apo publikë që kanë për detyrë mbledhjen e mbetjeve, duke filluar menjëherë nga Dita Efektive e kësaj Kontrate, konform Çmimit për Ton Mbetje të ofruar nga Koncesionari.

"Pagesa për Arritjen e Sasise Minimale të Garantuar të Mbetjeve" është pagesa për arritjen e Sasise Minimale të Garantuar të Mbetjeve e parashikuar në nenin 7.3. të kësaj Kontrate.

"Përfundim Paraprak" do të thotë se në lidhje me secilin Impiant ose Venddepozitim, Koncesionari njofton me shkrim Autoritetin Kontraktues se ndërtimi i Impiantit përkatës dhe/ose ndërtimi apo rehabilitimi i Venddepozitimit përkatës ka përfunduar dhe se sipas rasis dhe sa herë është e aplikueshme mund të fillojnë testet e performancës.

"Praktikë e mirë Industriale" është veprimi në mirëbesim për të përmbushur detyrimet me aftësinë dhe kujdesin e duhur në përputhje me kriteret ligjore dhe ato të praktikave të mira ndërkombëtare në industrinë e përpunimit të mbetjeve urbane në përgjithësi dhe ato të industrisë termodynamike në veçanti, në lidhje me projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e përpunimit të mbetjeve urbane, siç mund të pritet normalisht nga një kontraktor me aftësitë dhe përvojën e duhur.

"Projekt" do të ketë kuptimin e dhënë në nenin 2.2 të kësaj Kontrate.

"Projekt i Detajuar i Zbatimit" ose "Projekti i Zbatimit" është projekti i zbatimit që përgatitet nga Koncesionari dhe paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor dhe autoriteteve përkatëse për pajisjen me Licensë, Autorizime si dhe për Lejen Zhvillimore dhe/ose leje ndërtimi, etj., sipas kësaj Kontrate.

^



"**Prodhim Neto i Energjisë Elektrike**" është e gjithë energjia elektrike e transmetuar nga Impianti në pikën e shpërndarjes, nga Koncesionari, në çdo kohë deri në mbarimin e Afatit të kësaj Kontrate.

"**Punime Ndërtimi**" ose "**Punime**" janë punimet e nevojshme në funksion të ndërtimit dhe kompletimit të Veprave, Objekt i Kontratës, përfshirë çdo përgatitje të terreneve apo Shesheve dhe punimet e ndërtimit (për aq sa e është e aplikueshme) që duhet të kryhen në çdo Shesh me qëllim realizimin e Objektivit të Projektit.

"**Raporti Përfundimtar**" është raporti i përfundimit të Punimeve i cili hartohet nga Koncesionari, i dorëzohet Autoritetit Kontraktues në përfundim të Punimeve të Objektivit të Kontratës.

"**Rrjeti**" është rrjeti shqiptar i energjisë elektrike.

"**Sasia Minimale e Garantuar e Mbetjeve Urbane**" do të jetë sasia minimale e shprehur në ton për ditë kalendarike e **Mbetjeve Urbane** e garantuar për Koncesionarin për tu furnizuar, sipas percaktimeve të Planbiznesit, në faqen [26, 27, 28] të seksionit 6 (Parashikimi i të ardhurave) të tij, në Aneksin III i kësaj Kontrate,.

"**Sigurimi i Kontratës**" është vlera monetare e ngurtësuar në një llogari të posaçme ose e siguruar në një shoqëri sigurimesh që ushtron aktivitetin e saj në Republikën e Shqipërisë, me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së Kontratës nga Koncesionari.

"**SPV**" referuar termit të përdorur në Ligjin për Koncesionet, është shoqëria e krijuar posaçërisht për nënshkrimin dhe administrimin e kësaj Kontrate nga shoqëria **Integrated Energy B.V.**, e cila u shpall fituese në procedurën konkurruese të shpallur nga Ministria e Mjedisit.

"**Subjekti i Furnizimit me Energji Elektrike**" është personi juridik i licencuar nga ERE apo çdo ent tjetër rregullator i energjisë në Republikën e Shqipërisë, për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të Ligjit shqiptar.

"**Supervizor**" do të jetë subjekti i specializuar, i përzgjedhur në përputhje me nenin 6.2 të kësaj Kontrate, i cili do të supervizojë të gjithë Projektin dhe rehabilitimin dhe ndërtimin e të gjitha Venddepozitimeve dhe Impianteve dhe Veprave në tërësi.

"**Shesh(e)**" do të thotë trualli për çdo Vepër dhe Vepër Plotësuese, duke përfshirë Venddepozitimet, Impiantet, zona ose zonat në të cilën Impiantet apo pjesë të këtyre Impianteve apo strukturave ku do të vendosen dhe në të cilën kryhen aktivitetet dhe shërbimet e lidhura me ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Venddepozitimeve dhe Impianteve në atë masë që Koncesionari e ka të nevojshme për të ndërtuar



infrastrukturën e duhur në përputhje me këtë Kontratë, të drejtat mbi tokën dhe servitutet për:

- a) linjat e transmetimit;
- b) infrastrukturën e transportit, duke përfshirë rrugët dhe urat e ndërtuara për realizimin e Projektit, bashkelidhur kësaj Kontrate si Aneksi VII i saj.

"Shpronësim" në kontekstin e kësaj Kontrate do të nënkuptojë procedurën e shpronësimit, me fondet dhe shpenzimet e Autoritetit Kontraktor dhe/ose Njësive Vendore të Qarkut Tiranë, apo çdo Entiteti tjetër Shtetëror në përputhje me Ligjin e aplikueshëm, për të gjithë pronarëve ligjorë, informalë, apo në proces legalizimi / ligjërimit, mbi trojet apo ndërtimet e ndodhura në Shesh, apo çdo pronë tjetër e cila afektohet nga Projekti dhe që lind e nevojshme të shpronësohet.

"Tarifa Koncesionare" do të jetë sasia e energjisë elektrike prodhuar nga Koncesionari në favor të Autoritetit Kontraktues, e përcaktuar në Nenin 7.1.2 të kësaj Kontrate.

"Te ardhurat neto" janë të ardhurat e përfituara nga Koncesionari gjatë një viti kalendarik nga shitjet e produkteve të përfituara nga Objekti i Kontratës.

"Te Drejtat reale të pronësisë" janë ato të drejta që mundësojnë gëzimin dhe disponimin e plotë dhe ekskluziv të Shesheve dhe objekteve të lidhura me to që i transferohen Koncesionarit për qëllimet e realizimit të Projektit përgjatë të gjithë Periudhës së Koncesionit.

"Venddepozitime" për hir të përcaktimeve nën këtë Kontratë do të përfshijë bashkarisht dhe pa u kufizuar Venddepozitimin Ekzistues, Venddepozitimin e Mbetjeve të Ngurta, Venddepozitimin e Mbetjeve Inerte dhe çdo venddepozitim tjetër, pjesë e Projektit në tërësi.

"Venddepozitim Ekzistues" përfshin landfillin aktual në qytetin e Tiranës të ndodhur në Sharrë, 6 km nga qyteti i Tiranës, sipas hartës përkatëse në Aneksin 3, bashkelidhur kësaj Kontrate.

"Venddepozitimi i Hireve" do të jetë Venddepozitimi i mbetjeve në formë hiri, por pa u kufizuar vetëm në to, të prodhuara nga djegia e MNU-ve në Impiantin e Përpunimit të Mbetjeve, në përputhje me Aneksin VIII të kësaj Kontrate, dhe identifikuar si Lot F i Projektit.

"Venddepozitimi i Mbetjeve Inerte" do të jetë Venddepozitimi i mbetjeve të gjeneruara nga industria e ndërtimit në përputhje me të Aneksin VIII të kësaj Kontrate dhe identifikuar si Lot G dhe H i Projektit.



"Venddepozitimi i Mbetjeve të Ngurta Urbane" (Loti B) do të jetë venddepozitimi i ngritur nga Koncesionari, në përputhje me Aneksin VIII të kësaj Kontrate,

"Vepër" do t'i referohet veprave të përcaktuara nën Projekt, duke përfshirë por pa u kufizuar në Impiante, Venddepozitime, rrjete, etj., si pjesë e Projektit, ndërtimi i të cilave është objekt i Lejes Zhvillimore.

"Vepra Plotësuese" do jenë të gjitha veprat shtesë, në përputhje me nenin 2.2.2. të Kontratës, të cilat nuk janë pjesë e Projektit aktual, por që synojnë në përdorimin efikas të energjive të prodhuara nga Impiantet dhe diversifikimin e produkteve në kuadër të Operimit të Projektit.

"Veprim Shtetëror Thelbësishëm në Kundërshtim me Kontraten" është:

- a) Ngjarje me Risk Politik që ndikojnë drejtëpërsëdrejti ose në mënyrë indirekte në realizimin e Objektivit të Kontratës e cila mund të jetë çdo veprim nga ana e një organi shtetëror ose i një rregullatori të caktuar shtetëror që:
 - i. përbën abuzim të pushtetit qeveritar, ose është diskriminues nga vetë natyra apo efekti që krijon, ose është i papajtueshëm me Ligjin në fuqi në lidhje me operatorët e energjisë elektrike, dhe i cili krijon pengesa apo dëm,
 - ii. dhe çdo veprim i cili bie në kundërshtim me këtë Kontratë dhe do të çonte në pamundësi të Koncesionarit për të realizuar detyrimet kontraktore;
- b) Shpronësimi, rekuizimi, konfiskimi apo shtetëzimi i Impianteve, i kuotave të Koncesionarit ose të të drejtave të koncesionit;
- c) Çdo ndalim apo kushtëzim në marrjen dhe transferimin e përfitimeve apo të ardhurave të Koncesionarit, kapitalit apo borxheve (sipas Dokumenteve të Financimit) jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (përfshirë ndalimin dhe kufizimin e këmbimit jashtë shtetit);
- d) Dështimi i Autoritetit Kontraktues ose i një organi tjetër shtetëror për të bërë të disponueshëm çdo shesh apo t'i ndermjetësoje Koncesionarit të drejtat reale pronësisë gjatë Periudhës së Koncesionit, në përputhje me këtë Kontratë ose të sigurojë që Koncesionari të ketë gëzimin e qetë të Shesheve gjatë gjithë kohës së Kontrates dhe deri në fund të Afatit të saj;
- e) Kufizime të importit ose masa me efekt të ngjashëm, veçanërisht në lidhje me makineri dhe materiale të nevojshme për realizimin e Projektit, apo mbyllje të porteve apo shërbimeve të transportit apo lundrimit, qoftë të vendosura me ligj qoftë të vendosura nga ndonjë organ shtetëror (të ndryshme nga ato që mund të ekzistojnë ose që zbatohen në Datën Efektive të kësaj Kontrate);
- f) Kufizime ose masa me efekt të ngjashëm në lidhje me punësimin e personelit të nevojshëm, pavarësisht nga kombësia e tyre dhe/ose banimi, përveç kufizimeve për dënime penale nga gjykata kompetente;
- g) Çdo kufizim ligjor që ndalon Koncesionarin të shesë apo të eksportojë një pjesë të prodhimit të energjisë elektrike, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, përveç kufizimeve të parashikuara në këtë Kontratë;



- h) Çdo mospërmbushje e detyrimeve të parashikuara në këtë marrëveshje nga ana e Autoritetit Kontraktues;
- i) Një ndryshim në legjislacion ose në aktet nënligjore që ndikojnë drejtëpërsëdrejti ose në mënyrë indirekte në realizimin e Objektivit të Kontratës.

"Vlera e Projektit" është vlera e investimit për ndërtimin dhe administrimin e Objektivit të Kontratës përgjatë gjithë Afatit të Kontratës, referuar dispozitës përkatëse në këtë Kontratë.

"Vlerë Investimi" është vlera monetare totale e investimit për Projektin dhe tërë komponentët e tij, e parashikuar në ofertën e Koncesionarit.

"Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis" është raporti i vlerësimit të ndikimit të projektit në mjedis sipas përcaktimeve të ligjit nr.10440, datë 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar.

1.2 Interpretime:

Përveç kur nuk sqarohet ndryshe në këtë Kontratë:

- a. fjalët në secilën gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjëanëse;
- b. fjalët që përdorin numrin njëjës ose shumës përfshijnë gjithashtu respektivisht numrin shumës ose njëjës;
- c. termat "të kësaj", "këtu", "nëpërmjet kësaj ose nga kjo", "në këtë" dhe fjalë të ngjashme i referohen Kontratës në tërësi dhe jo ndonjë dispozitë, Paragrafi, Tabele, Aneks ose Grafiku apo ndonjë nënndarje tjetër të kësaj Kontrate;
- d. Shtojcat, Tabelat dhe Aneksat të kësaj Kontrate do të përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate dhe referencat në Shtojcat, përveç kur Palët kanë rënë dakort ndryshe;
- e. referencat në ndonjë akt përfshijnë çdo ndryshim ose ri-nxjerrjeje të atij akti, si dhe çdo rregull ose rregullore të nxjerrë në zbatim të këtij akti dhe referencat në një ligj do të thotë referencë në një ligj të fillë, siç mund të jetë ndryshuar ose rinxjerrë a ribërë;
- f. fjalët "përfshin" ose "duke përfshirë" do të konsiderohet se pasohen nga [fjalët] "pa kufizim" ose "duke mos u kufizuar në", edhe nëse ato ndiqen ose jo nga fraza ose fjalë të tilla të ngjashme;
- g. referencat në "këtë kontratë" ose "kjo kontratëKoncesioni" ose çdo marrëveshje ose dokument tjetër do të interpretohen si referenca në këtë Kontratë, siç ndryshohet, modifikohet ose shtohet dhe që janë në fuqi nga koha në kohë, si dhe do të përfshijnë referencën në çdo dokument që e ndryshon, modifikon ose e shton atë, ose që është lidhur, bërë ose dhënë në zbatim ose në përputhje me kushtet e saj
- h. sa herë që kjo Kontratë i referohet një numri të "ditëve", ky numër do t'i referohet ditëve tëpunës;



- i. çdo reference në një "muaj" apo një "vit" do të interpretohet si një referencë për një muaj kalendarik apo vit kalendarik;
- j. çdo fjalë, term, frazë dhe shkurtim që fillon me shkronjë të madhe e përdorur specifikisht në ndonjë Aneks apo Dokument tjetër bashkangjitur do të ketë kuptimin e përcaktuar në këtë Aneks apo dokument sipas rasti;
- k. në rast mospërputhjeje midis ndonjë fjale me germë të madhe, termi të përcaktuar, fraze ose shkurtimi të parashikuara në paragrafin 1.1 dhe një dispozite, fjale me germë të madhe, termi, frazë ose shkurtimi parashikuar gjatë në këtë Kontrate, Aneks ose në një Dokument tjetër bashkangjitur, kuptimi i dhënë në paragrafin 1.1 do të ketë përparësi, përveç kur konteksti i kësaj Kontrate e kërkon ndryshe;
- l. në rast të një konflikti midis tëkësajKontrate dhe anekseve, Palët do të përpiqen, në radhë të parë, për të zgjidhur konfliktin duke lexuar këtëKontratë si një të tërë dhe përparësi kanedispozitat që janë më specifike. Në qoftë se konflikti vazhdon pavarësisht përpjekjeve të Palëve për ta zgjidhur me mirëkuptim, atëherë konflikti zgjidhet duke pasur parasysh objektivin e marrëveshjes dhe tërësinë e dispozitave të saj;
- m. kërret në këtë Kontrate kanë për qëllim të lehtësojnë leximin e saj dhe nuk ndikojnë në asnjë mënyrë në interpretimin e kësaj Kontrate.


Pa paragjykim ndaj paragrafit të mësipërm, nëse ka ndonjë konflikt apo mospërputhje ndërmjet dispozitave dhe Anekseve dhe/ose ndonjë shtojcë të Anekseve dhe/ose çdo dokumenti tjetër që i referohemi në këtë Kontratë, konflikti apo mospërputhja do të zgjidhet sipas rendit të mëposhtëm të përparësisë:

- a) Dokumentat Standart te procedurës konkurruese;
- b) Oferta e Koncesionarit;
- c) Dispozitat e kësaj Kontrate;
- d) Çdo Aneks i tyre;
- e) Çdo dokument tjetër të cilit i referohemi në këtë Kontratë ose çdo dokument tjetër bashkëlidhur kësaj Kontrate.

2.OBJEKTI I KONCESIONIT, PROJEKTI DHE VEPRAT PLOTËSUESE

2.1. Objekti i Koncesionit

Me anë të kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues, i autorizuar nga legjisllacioni në fuqi i jep Koncesionarit, me koncesion të formës BOT (ndërtim, operim dhe transferim i së drejtës së pronësisë dhe operimit, në përfundim të Kontratës së Koncesionit), financimin, projektimin, rehabilitimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Veprave dhe Veprave Plotësuese për Mbetjet e Qarkut Tiranë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike, për



Periudhën e Koncesionit (ashtu sic definohet në nenin 4) si dhe transferimin e tij në përfundim të Kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.

Pas dorëzimit të Objektivit të Kontratës nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktor në përfundim të Periudhës së Koncesionit, ky i fundit do t'ia transferojë si aset në pronësi Bashkisë Tiranë për administrim të mëtejshëm.

2.2. Projekti

2.2.1 Me Projekt në këtë Kontratë do të nënkuptohen:

(i) ndërtimi / rehabilitimi i të gjitha Veprave dhe Veprave Plotësuese, ashtu siç përcaktohet në mënyrë të detajuar në Aneksin VIII të kësaj Kontrate dhe sipas Grafikut të Punimeve, pjesë e kësaj Kontrate si Aneksi IV i saj dhe konkretisht Veprat e mëposhtme:

1. Kapsulimi i Venddepozitimit Ekzistues, LOT A;
2. Impianti i Përpunimit të Ujrave të Ndotura, LOT E;
3. Impianti i Diferencimit të Mbetjeve, LOT D;
4. Venddepozitimi i Mbetjeve të Ngurta Urbane, LOT B;
5. Impianti i Përpunimit të Mbetjeve, LOT C;
6. Nënstacioni Elektrik, LOT I;
7. Venddepozitimi i Hireve, LOT F;
8. Venddepozitimi i Mbetjeve Inerte, LOT G dhe H;

(ii) operimi ekskluziv nga Koncesionari i të gjitha Veprave përgjatë Periudhës së Koncesionit, përfshirë por pa u kufizuar në manaxhimin, depozitimin e Mbetjeve, prodhimin e energjisë elektrike, importimin e lendeve djegëse ndihmese të procesit të funksionimit të Impianteve, në përputhje me Ligjin, me qëllim rritjen e efikasitetit të tyre, apo aktivitete të tjera në kuadër të operimit dhe shfrytëzimit të Veprave dhe Veprave Plotësuese; dhe

(iii) transferimi tek Autoriteti Kontraktues në përfundim të Periudhës së Koncesionit.

2.2.2. **Veprat Plotësuese:** Palët bien dakord se përtej Veprave të parashikuara në Projekt, me qëllim rritjen dhe shfrytëzimin e efikasitetit të Impianteve dhe energjive të prodhuara, Koncesionari mund të kërkojë nga Autoriteti Kontraktor lejimin për ndërtimin e **Veprave Plotësuese**, që synojnë përmirësimin e efikasitetit në energji, duke sjellë diversifikimin e produkteve të Projektit; të tilla si: (i) sera me avull; (ii) veprimtari në agro-biznes, apo (ii) çdo veprimtari tjetër ekonomike në kuadër të diversifikimit të produkteve, kërkesa të cilat nuk mund të refuzohen në mënyrë të përsoshme nga Autoriteti Kontraktor, duke kërkuar modifikimin e Projektit, apo duke aplikuar për lejet përkatëse përfshirë modifikimin e Lejes Zhvillimore, apo çdo Autorizimi apo Leje / Liçense për Koncesionarin.



2.2.3. Me qëllim rritjen e rentabilitetit/maksimalizimit të investimeve të Koncesionarit, ky i fundit, ka të drejtë të marrë dhe të furnizohet me Mbetje edhe nga njësi vendore të qarqeve të tjera ose persona të tretë private ose publikë, për aq sa kjo nuk cenon përmbushjen e detyrimeve dhe sasise të Mbetjeve Urbane që Koncesionari ka sipas kësaj Kontrate.

2.2.4. Koncesionari ka të drejtën e tij dhe mund të ndryshojë karakteristikat e përcaktuara në Projekt (duke respektuar Ofertën në bazë të së cilës është lidhur kjo Kontratë) gjatë hartimit dhe në prezantimin e Projektit të Zbatimit, në mënyrë që të mund të optimizojë skemën e shfrytëzimit të Impianteve dhe Veprave sipas Objektivit të kësaj Kontrate në përputhje me skemën teknologjike dhe nevojat e arsyeshme të Koncesionarit, me kusht që Autoriteti Kontraktor të japë miratimin me shkrim për këtë ndryshim, miratim i cili nuk mund të refuzohet në mënyrë të pa-arsyeshme nga Autoriteti Kontraktor.

3. KARAKTERISTIKAT E VEPRAVE

Veprat, duke përfshirë por pa u limituar në Venddepozitet dhe Impiantet që do të rehabilitohen dhe/ose ndërtohen dhe administrohen nga Koncesionari referuar Afatit të kësaj Kontrate dhe karakteristikat e tyre do të jenë në përputhje me përcaktimet e Aneksit VIII, bashkëlidhur kësaj Kontrate.

4. PERIUDHA E KONCESIONIT

4.1. Koncesioni jepet për një periudhë prej 30 (tridhjetë) vitesh, duke filluar nga Data Efektive dhe përfundon në ditën e përvjetorit të tridhjetetë kësaj date ("Periudha e Koncesionit").

4.2. Rastet e zgjatjes së Periudhës së Koncesionit do të jenë si më poshtë:

4.2.1. Palët bien dakord se për çdo vonesë të shkaktuar për shkak të jashtëkontrollit dhe/ose për faj jo të Koncesionarit që do të sillnin si pasojë shtyrjen e Datës së Fillimit të Punimeve dhe / ose Datës së Përfundimit të Punimeve, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në shkaqe të tilla si: mos-pajisja apo vonesa në pajisjen me Lejen Zhvillimore, apo Autorizimet ose Lejet/Licensat, brenda afateve të përcaktuara në këtë Kontratë nga Autoriteti Kontraktor, Njësitë Vendore të Pushtetit Lokal ose çdo Entitet Shtetëror, apo çdo lloj vonese, apo shtyrje të shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, ose Njësitë vendore të Qarkut Tiranë, ose ERE, ose çdo Entitet Shtetëror, Periudha e Koncesionit do të zgjatet automatikisht, për një periudhë kohe të barabartë me periudhën e vonesës së shkaktuar.

4.2.2. Palët bien dakord se Periudha e Koncesionit do të zgjatet në rastin e një Ngjarjeje të Forcës Madhore, për një periudhë kohe të barabartë me kohën që ka zgjatur Ngjarja, plus kohën e arsyeshme që nevojitet për riparimin e dëmeve të shkaktuara, me kusht që vetë Ngjarja të ketë zgjatur për një periudhë më të gjatë se 1 (një) muaj.

KREU II
TE DREJTAT KONCESIONARE



5. TË DREJTAT E KONCESIONIT

5.1. Sipërmarrja e Përgjithshme


Palët kanë detyrimin të bashkëpunojnë në mënyrë aktive dhe efektive me qëllim realizimin e Projektit, në mënyrë eficiente dhe sa më shpejt që të jetë e mundur. Autoriteti Kontraktues, së bashku me Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë kanë detyrimin të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për sigurimin e bashkëpunimit dhe mbështetjen e të gjitha Entiteteve Shtetërore si dhe Njësive Vendore të Qarkut Tiranë, me qëllim realizimin e Projektit brenda afatit.

5.2. Dhënia e te drejtave të Koncesionit

5.2.1. Duke filluar nga Data Efektive, Autoritetit Kontraktues i jep Koncesionarit, i cili pranon, të gjitha drejtat ekskluzive në lidhje me Projektin, për të gjithë Periudhën e Koncesionit, për projektimin, financimin, ndërtimin apo rehabilitimin, testimin, administrimin, pronësinë dhe operimin/përdorimin ekskluziv të Impianteve, Venddepozitimeve dhe në tërësi të gjitha Veprave dhe Veprave Plotësuese, sipas Objektivit të Kontratës;

- a) të drejtën për marrjen në posedim, shfrytëzimin dhe Gëzimin e Qetë të të gjitha Shesheve, Veprave, dhe aseteve të këtij Projekti;
- b) Autoriteti Kontraktues dhe/ose Bashkia Tirane i dorëzojnë Venddepozitimin Ekzistues menjëherë Koncesionarit, por jo me vone se 30 ditë nga Data Efektive, në mënyrë që Koncesionari të fillojë menjëherë Operimin e Venddepozitimit Ekzistues duke marrë në dorëzim të gjithë Mbetjet për përpunimin e tyre sipas Objektivit të Kontratës
- c) marrjen në dorëzim dhe operimin, shfrytëzimin dhe përdorimin e të gjitha Shesheve të percaktuar në Aneksin VII të kësaj Kontrate nga Bashkia Tiranë, brenda afateve të percaktuara në këtë Kontratë, me qëllim aktivitetin e marrjes në dorëzim dhe përpunimit të të gjitha Mbetjeve, konform Objektivit të kësaj Kontrate dhe Projektit në tërësi, përkundrejt aplikimit të Çmimit për Ton Mbetje;
- d) të shesë dhe të furnizojë me Prodhim Neto të Energjisë Elektrike, jo vetëm palët e trefa me të cilët hyn në marrëdhënie kontraktore në Republikën e Shqipërisë por edhe operatorë të tjerë jashtë saj, të mbledhë dhe të përfitojë të ardhura nga ky aktivitet me kusht që:

i. Koncesionari të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për prodhimin, transmetimin dhe shitjen e energjisë elektrike gjatë aktivitetit të tij, dhe



ii. Koncesionari të përmbushë detyrimin e shërbimit publik, të vendosur në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" si dhe çdo detyrimi që del nga Ligji 7/2017 "Për nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme";

- e) T'i kthejë Autoritetit Kontraktues, në mbarim të Periudhes së Koncesionit të drejtën e përdorimit dhe/ose pronësisë së Shesheve, Veprave dhe/ose Veprave Plotësuese, si dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për këtë qëllim, sipas Objektivit të Kontrates.

5.2.2. Kjo Kontratë Koncesioni përbën një projekt BOT (Build – Operate – Transfer "NDERTO OPERO TRANSFERO"). Të gjitha Veprat dhe çdo ndërtim tjetër pranë Venddepozitimeve, Impianteve, apo në përgjithësi në kuadër të Projektit do të regjistrohen në emër dhe në pronësinë e Koncesionarit përgjatë gjithë Periudhës së Koncesionit. Koncesionarit i njihet dhe regjistrohet në emër të tij gjithashtu pronësia mbi çdo ndërtim që ai do kryejë brenda Shesheve, në përputhje me Ligjin. Koncesionari mund t'i vendosë si garanci Veprat, këtë Kontratë, të drejtat e tij mbi pasuritë e paluajtshme, në favor të Institucioneve Financiare / Huadhënësve, qofshin këto vendas apo të huaj, banka vendase apo të huaja, për të siguruar financimin e Projektit si dhe pagimin e çdo shume apo huaje financiare të marrë për financimin e Projektit duke përfshirë qoftë ndërtimin ashtu edhe operimin, brenda dispozitave të Ligjit të aplikueshëm. Me mbarimin e Periudhës Koncesionare dhe/ose zgjatjeve eventuale, Koncesionari transferon tek Autoriteti Kontraktues të gjitha kuotat në kapitalin e tij, si dhe të gjitha të drejtat e tjera pasurore, që lidhen me Objektivin e Koncesionit .

5.2.3. E drejta e përdorimit të Shesheve dhe asetëve mund të lihet peng ose garanci tek Institucionet Financiare për të njëjtin Afat për të cilin i posedon Koncesionari për realizimin e Projektit, por në përfundim të këtij afati, Sheshet dhe cdo asetet do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues, të lira nga cdo barrë, peng apo garanci.

5.3. Dhënia e Shesheve

Pavarësisht përcaktimeve të paragrafit 5.2 më sipër:

- a) Disponimi ekskluziv i Shesheve, e Drejta e Kalimit, Gëzimi i Qetë dhe e drejta ekskluzive për aksesin dhe e përdorimit të Shesheve të Veprave i jepet Koncesionarit.
- b) Në lidhje me disponimin e Shesheve, të Drejtën e Kalimit, Gëzimin e Qetë dhe të drejtat për aksesin dhe përdorimin e sheshit në përputhje me Ligjin, Koncesionari pranon Sheshet "në kushtet në të cilat ndodhen" dhe që nga data e dhënies, Autoriteti Kontraktues nuk do të jetë më përgjegjës ndaj Koncesionarit në lidhje me gjendjen e Shesheve. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës ndaj Koncesionarit për kostot e riparimit, në atë masë që kërkohet nga ligjet në fuqi, të

ndonjë Ndotje Ekzistuese të Mjedisit dhe Koncesionari do të çlirohet dhe do të mbahet i padëmtuar nga çdo pretendim i të tretëve, që pretendojnë se janë dëmtuar nga kjo Ndotje Ekzistuese e Mjedisit.


5.4. Marrëveshjet dhe bashkëpunimi i Autoriteti Kontraktues

5.4.1. Në çdo kohë dhe gjatë gjithë Kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues i siguron dhe garanton Koncesionarit akses në Sheshet e Venddepozitimeve dhe Sheshet e përcaktuara për ndërtimin e Veprave si dhe në Rrjetin Elektrik.

5.4.2. Përgjatë të gjithë Kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues dhe as ndonjë Entitet tjetër Shtetëror, qoftë ky në nivel qendror, apo vendor, nuk do të japë askujt të drejta të shfrytëzojnë, të përdorin dhe përpunojnë Mbetjet Urbane të Qarkut Tiranë si dhe të drejtën e administrimit, përdorimit, apo ngritjes së Venddepozitimeve të Mbetjeve Urbane apo ndërtimin e Impianteve në këtë zonë që do të sillte si pasojë rënien e Sasisë Minimale të Garantuar të Mbetjeve. Në rast se Autoriteti Kontraktues ndërmerr ndonjë veprim në shkelje të këtij neni dhe verifikohen pasojat e parashikuara në paragrafët e mësipërme ose dështon në ndërmarrjen e veprimeve që mund të eliminonin këto pasoja, ai duhet të rivendosë Koncesionarin në gjendjen e mëparshme. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk e rikthen në gjendjen e mëparshme brenda 60 ditësh nga data në të cilën Koncesionari ka njoftuar për këto pasoja, kjo rrethanë konsiderohet si shkelje e dispozitave të kësaj Kontrate dhe Koncesionarit i lind e drejta ta zgjidhë atë dhe të kërkojë të gjitha dëmshpërblimet.

5.4.3. Në çdo kohë përgjatë Afatit të kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues është i detyruar, brenda kufijve të Ligjit:

- a) të ndihmojë dhe asistojë në më të mirën e mundshme Koncesionarin me pajisjen me të gjitha dhe çdo Autorizim, Leje / License, duke përfshirë por pa u kufizuar në Lejen Zhvillimore, leje ndertimi, leje te perkohshme, me kerkesë të Koncesionarit në përputhje me Projektin e Zbatimit.
- b) të garantojë Koncesionarin mbi realizmin e detyrimit të Subjektit të Furnizimit me Energji Elektrike, për të blerë energjinë elektrike të prodhuar nga Impianti i Përpunimit të Mbetjeve, në përputhje me dispozitat rregullatore të energjisë në fuqi.
- c) Të garantojë mbështetjen për Koncesionarin (të ndikojë pranë autoriteteve të tjera shtetërore) për Fillimin, vazhdimin e punimeve deri në përmbushje të plotë të Objektivit të kësaj Kontrate sipas Projektit të Zbatimit, duke mundësuar realizimin e qetë të Punimeve pa i nderprere ato;
- d) Të garantojë pagesat përkatëse nga të gjitha Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë që do të depozitojnë Mbetjet, në



kohën e duhur dhe brenda të gjitha afateve në përputhje me Çmimet / Tarifat dhe afatet e pagesave të përcaktuara nën këtë Kontratë;

- e) Te garantoje mundesimin dhe pajisjen me Lejen Zhvillimore, Autorizimet, Lejet/Lincesa perkatese te Koncesionarit;
- f) T'i garantoje Koncesionarit aksesin, lidhjen dhe perdorimin e lirshem, pa bllokime apo pengesa ne rrjetet publike ose private te energjise, ujit, kanalizimeve, rrugeve, etj;
- g) T'i sigurojë Koncesionarit, me qëllim veprimin nga Bashkia Tiranë, aksesin e menjehershëm posacerisht në lidhje me Venddepozitimin Ekzistues për të mundësuar koordinimin e Punimeve dhe mos-pengimin e Koncesionarit gjatë Punimeve të Ndertimit;
- h) T'i vere në dispozicion Koncesionarit, apo të bëjë të mundur nga Bashkia Tirane, apo Enitetet Shteterore aksesin dhe dorezimin e te gjitha zonave, parcelave, Shesheve ku do te shtrihet Projekti, perfshire por pa u kufizuar në karrierat e argjilës dhe inerteve brenda Shesheve te perfshira në Projekt ne menyre qe Koncesionari te kryejë depozitim-shkarkimin e cdo materiali, germimi, etj. gjatë Punimeve të Ndertimit;

Të gjitha garancitë e mësipërme të përcaktuara në nenin 5.4.3. nga Autoriteti Kontraktor në favor të Koncesionarit, do jenë të vlefshme përsa kohë Koncesionari ka përmbushur të gjitha detyrimet e veta, në lidhje me çështjet e këtyre garancive.

5.5. Objektet e transmetimit

5.5.1. Konçesionari është përgjegjës për ndërtimin e linjave të transmetimit, me shpenzimet e tij sipas Ligjit.

5.5.2. Linjat e transmetimit të ndërtuara nga Konçesionari, do të lidhen në Rrjet në pikat më të përshtatshme dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në kuadrin rregullator në fuqi dhe në kontratën që Koncesionari do të lidhë me Subjektin e Furnizimit me Energji Elektrike.

5.6. Krijimi i zonave të sigurisë

Nga Data e Fillimit të Punimeve deri në fund të Afatit të kësaj Kontrate, Koncesionari është përgjegjës për të gjitha rreziqet e dëmeve që mund t'u shkaktohen të tretëve. Këto kosto, lidhen me dëmet që mund t'i shkaktohen palëve

të treta si pasojë e ndërtimit dhe Operimit të Objektivit të Koncesionit të cilat do të përballohen nga Koncesionari.

5.7. Shpronësimet

Nga Data Efektive e kësaj Kontrate dhe brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muajsh, Autoriteti Kontraktor do të ketë siguruar përfundimin e plotë dhe pa asnjë defekt, të procesit të Shpronësimeve të parcelave, pronave brenda Shesheve, pa asnjë të metë dhe me qëllim fillimin e Punimeve menjëherë dhe pa vonesa nga Koncesionari, konform afateve të përcaktuara këtu. Detyrimi për kryerjen e të gjitha dhe çdo Shpronësimi dhe procedure lidhur me të, dhe shpenzimet, fondet, kostot dhe vlerat respektive për këto Shpronësimet në favor të të shpronësuarve, do të jenë në ngarkim dhe përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues dhe/ose Bashkisë Tiranë, apo çdo Entiteti Shtetëror përgjegjës me Ligj.

5.8. Leja Zhvillimore

Nga Data Efektive e kësaj Kontrate dhe brenda një periudhe prej 8 (tetë) muajsh, Autoriteti Kontraktor do të ketë siguruar në favor të Koncesionarit dhënien dhe zbardhjen e Lejes Zhvillimore për të gjithë Projektin, ose pjese-pjese per faza te ndara te Punimeve te Ndertimit, sipas zgjedhjes dhe aplikimit per Lejet perkatese, perfs hire por pa u kufizuar ne lejen / lejet e ndertimit, me qëllim fillimin e Punimeve menjëherë dhe pa vonesa nga Koncesionari, si edhe dhënien Koncesionarit të certifikates/certifikatave perkatese të përdorimit lëshuar nga autoriteti kompetent ne fushen e zhvillimit te territorit.

5.9. Ndotja Mjedisore në Venddepozitimin Ekzistues dhe brenda Shesheve

Palët bien dakord dhe pranojnë se Koncesionari nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi dhe do të mbahet i padëmtuar përsa i përket Ndotjes Ekzistuese e Mjedisit pranë dhe në Venddepozitimin Ekzistues dhe brenda Shesheve, dhe do të jetë i çliruar dhe do të mbetet i padëmtuar nga çdo pretendim, kërkesë, apo padi në lidhje me dëme pasurore të lidhura më të, përfshirë dëmtimin e tokës, ujit, dherave, ujrave të nëndheshëm dhe ajrit, etj. pavarësisht nëse dëmi ka ardhur përpara ose pas Datës Efektive, dhe Koncesionari do të mbetet i padëmtuar nga të gjitha dhe çdo pretendim, kërkesë apo padi të cfarëdolloji i të tretëve lidhur me Ndotjen Ekzistuese të Mjedisit.

5.10. Angazhimi i Njësisë Vendore të Qarkut Tiranë

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë do të miratojnë konform Ligjit dhe do të nënshkruajnë njëkohësisht Aneksin IX, "Forma e Angazhimit mbi detyrimet e njesive vendore te Qarkut Tirane", duke marrë të gjitha dhe çdo vendim në lidhje me këtë nënshkrim, ashtu sic kërkohet nga legjislacioni në fuqi nga ku këto njësi (Bashki) marrin përsipër të gjitha dhe çdo detyrim, angazhim nën këtë Kontratë. Aneksi IX do të konsiderohet si pjesë

përbërëse integrale e kësaj Kontrate, vecanerisht duke patur parasysh rolin e rëndësishëm që këto njësi (Bashki) do kenë nën këtë Kontratë.

5.11. Bashkëpunimi mes Entiteve Shtetërore

Autoriteti Kontraktor dhe Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë do të bashkëpunojnë në favor të kësaj Kontrate, së bashku me Koncesionarin me qëllim shmangien dhe evitimin e mbivendosjeve me këtë Projekt, të marrëveshjeve apo iniciativave të njëjtës natyre me Projektin nga këto njësi vendore, në cilësinë e përfituesve.

6. MARRËVESHJET (FAZA PARA NDËRTIMORE DHE NDERTIMORE)

6.1. Njësia e Zbatimit të Projektit (NJZP)

6.1.1. Brenda një muaji nga Data Efektive, Palët krijojnë NJZP-në, e cila do të përbëhet nga pesë anëtarë që caktohen si më poshtë:

- Dy anëtarë, të caktuar nga Autoriteti Kontraktues;
- Një anëtar, të propozuar nga Ministria Përgjegjëse për energjinë;
- Dy anëtarë, të caktuar nga Bashkia Tiranë.

6.1.2. NJZP-ja monitoron përmbushjen nga Koncesionari të detyrimeve të tij, në lidhje me përmbushjen e Objektivit të kësaj Kontrate dhe konfirmim detyrave të përcaktuara këtu nën këtë Kontratë.

6.1.3. NJZP-ja mblidhet, sa herë të jetë e nevojshme, por ajo do të mblidhet të paktën një herë në 3 (tre) muaj.

6.2. Supervizori

Perpara Datës së Fillimit të Punimeve për rehabilitim dhe/ose ndërtim të Venddepozitimeve aktuale dhe të ardhshme dhe çdo Impianti dhe Veprë në tërësi, Koncesionari do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktor, tre Studio të mirënjohura dhe me mjaft eksperiencë në fushën e supervizimit, për ndërtimin dhe operimin e objekteve të ngjashme dhe NJZP do të bëjë përzgjedhjen e njërit prej tyre si Supervizor të Koncesionarit. Supervizori do të supervizojë ecurinë dhe punimet e të gjithë Projektit, në çdo komponent, Lot, apo fazë të tij, dhe do të dorëzojë çdo fund 3-mujori pranë NJZP-së një dokumentacion të plotë mbi ecurinë e punimeve, të shoqëruar me situacionet përkatëse të firmosura prej tij. Pas firmosjes së situacioneve nga ana e Supervizorit, ky i fundit dorëzon situacionet për firmojse nga titullari i Autoritetit Kontraktor ose i deleguari i tij.

6.3. Monitorimi dhe inspektimi i ndërtimit të Venddepozitimeve dhe Impianteve (Veprave)



Përveç monitorimit dhe inspektimit nga Entitetet përkatëse Shtetërore në përputhje me Ligjin Shqiptar, Autoriteti Kontraktues mund ta monitorojë dhe inspektojë ndërtimin gjatë Fazës së Ndërtimit në prani të Koncesionarit, pasi i jep një njoftim të mëparshëm të arsyeshëm Koncesionarit; me kusht që, gjithsesi, ky monitorim dhe inspektim të mos shkaktojë ndonjë pengesë të paarsyeshme, të ndërhyjë në progresin e ndërtimit ose të ndërpresë ndërtimin. Rezultatet e monitorimit dhe inspektimit do të përmbledhen me shkrim dhe nënshkruhen menjëherë më pas nga të dyja Palët. Koncesionari i raporton Autoritetit Kontraktues çdo 3 (tre) muaj mbi:

- i. Ecurinë e punimeve dhe masat e marra për eliminimin e vonesave.
- ii. Zbatimin e kontrollit të cilësisë dhe të sistemeve të sigurimit;
- iii. Të dhëna mbi shëndetin e punonjësve dhe aksidentet eventuale në punë;
- iv. Pretendimet e palëve të treta;
- v. Ngjarje apo rrethana për të cilat Autoriteti Kontraktues është ose mund të jetë përgjegjës sipas kësaj kontrate.

6.4. Dispozita të përgjithshme

6.4.1. Palët do të mbështesin njëra-tjetrën dhe do të bashkëpunojnë në mirëbesim me qëllim që Koncesionarit t'i garantohet në kohë dhe brenda afatave të përcaktuara këtu, dorëzimi i Shesheve dhe shfrytëzimi i të gjitha pasurive të paluajtshme, si dhe marrja e çdo Autorizimi, Leje / License të aplikueshme, përfshirë por pa u kufizuar në Lejen Zhvillimore, dhe/ose lejen/t e ndërtimit për të gjithë Projektin apo për fazat e ndara sipas Loteve dhe/ose Moduleve dhe/ose Veprave të veçanta, sipas nenit 5.8 me sipër, të nevojshme për realizimin e Projektit.

6.4.2 Palët, duke mbajtur parasysh kompleksitetin e Projektit dhe proceset që kushtëzojnë Fillimin e Punimeve nga Koncesionari duke përfshirë por pa u kufizuar në Shpronësimin apo pajisjen e Koncesionarit me Leje Zhvillimore, Autorizime, Leje/Licensa, apo Operimin nga Koncesionari të Veprave në tërësi (referuar bashkërisht në këtë nen si "Proceset"), vendosin dhe bien dakord se çdo vonesë apo shtyerje në finalizimin dhe përfundimin me sukses të Proceseve, që nuk kanë ardhur si pasojë e neglizhencës së Koncesionarit, do të shtyjë automatikisht dhe pa asnjë penaltet të aplikueshëm për Koncesionarin, me një periudhë të barabartë me vonesën, të gjitha dhe çdo afat nën këtë Kontratë, përfshirë Datën e Fillimit të Punimeve, Grafikonin e Punimeve dhe Periudhën e Koncesionit, duke mbajtur Koncesionarin të padëmtuar.

6.5. Te drejtat mbi pasuritë së paluajtshme (Sheshet)

6.5.1. Koncesionari do të marrë brenda 30 ditëve nga Data Efektive e kësaj Kontrate, në dorëzim sheshin e Venddepozitimit Ekzistues dhe parcelat e tjera, pjesë e Shesheve, që janë në pronësi, apo administrim të Entiteteve Shtetërore (pjesë e këtij Projekti dhe që nuk janë objekt Shpronësimi) dhe jo më vonë se 6 (gjashtë)



muaj (pra koha e nevojshme për kryerjen e shpronësimeve) nga Data Efektive e kësaj Kontrate pjesën e mbetur të të gjitha Shesheve, ashtu siç përcaktohen në Aneksin VII bashkëlidhur kësaj Kontrate. Pavarësisht përfundimit të procesit të Shpronësimit të parcelave të veçanta, pjesë e Shesheve, në sheshet pronë, apo në administrim të Entiteteve Shtetërore, Autoriteti Kontraktor dhe/ose Bashkia Tiranë do t'i sigurojnë Koncesionarit akses në to, me qëllim kryerjen dhe zbatimin e atyre detyrave në Projekt që mund të realizohen nga Kontraktori, me qëllim shpejtimin e procesit të ndërtimit, konform Grafikut të Punimeve.

6.5.2. Jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga Data Efektive e kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues, dhe/ose nëpërmjet Bashkisë Tiranë do të vendose/in në dispozicion të Koncesionarit, pa pagesë, të gjitha Sheshet dhe parcelat respektive ku do të ndërtohen Venddepozitimet (përveç Venddepozitimit Ekzistues i cili do të dorëzohet brenda 30 ditësh nga Data Efektive) dhe Impiantet, pjesë e Projektit, dhe Objekt i kësaj Kontrate dhe i transferon lirisht dhe pa pagesë Koncesionarit servitutet apo të drejta reale të ngjashme për realizimin e Projektit (p.sh., të drejtat e ndërtimit, servitute të tjera dhe të drejtat e kalimit). Këto të drejta reale pronësie në lidhje me Sheshet, do të:

- a) Vërtetohen/krijohen, sipas kësaj Kontrate, dhe kjo Kontratë Koncesioni, do të regjistrohet në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ("ZVRPP"), në favor të Koncesionarit, me qëllim sigurimin e të drejtave të Koncesionarit sipas kësaj Kontrate mbi këto Sheshe, dhe pa qenë e nevojshme ekzekutimi i marrëveshjeve të tjera shtesë me Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë, apo Entitete të tjera Shtetërore. Koncesionari do ketë të drejtë që për çdo pasuri apo parcelë të veçantë e konsideruar si pjesë e Shesheve, apo në funksion të Objektivit të Projektit, (veçanërisht në rastin e Shpronësimeve) brenda 30 ditëve nga dalja e çertifikatave të pronësisë dhe/ose kartelave të pasurive / parcelave të Shesheve të ri-depozitohet këtë Kontratë pranë ZVRPP, me qëllim perfeksionimin e të drejtave të tij, sipas kësaj Kontrate.
- b) Jenë në favor të Koncesionarit, të lira nga çdo peng apo barrë dhe nuk shërbejnë si garanci në favor të të tretëve;
- c) Të drejtat e siguruara nga Koncesionari do të jenë lirisht të transferueshme, në masën e lejuar nga Ligji dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit, tek Institucionet Financiare / Huadhënësit.

6.5.3. Vetë Autoriteti Kontraktues, apo Bashkia Tiranë do të fillojë menjëherë procesin e Shpronësimit për parcelat e Shesheve, pas dorëzimit nga Koncesionari të dokumentacionit dhe kërkesës përkatëse. Sa më sipër, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, apo çdo Entitet Shtetëror do të kryejë brenda afateve procesin e Shpronësimit të parcelave të Shesheve të cilat janë pronë private, si dhe do të



realizojë procedurat e nevojshme të Shpronësimit me sa më efikasitet të jetë e mundur në përputhje me Ligjin dhe brenda të gjitha afateve të përcaktuara në këtë Kontratë, ku:

a) Parcela te tilla te Shesheve do të jenë të lira nga çdo barrë;

b) Për shmangien e çdo dyshimi:

(i) çdo parcelë, e shpronësuar sipas ligjit do të konsiderohet e përfshirë në Shesh (edhe përsa i përket Gëzimit të qetë) që nga data e shpronësimit të saj dhe vënies në dispozicion të Koncesionarit;

(ii) Autoriteti Kontraktues do të marrë masat për fillimin e procedurave të shpronësimit me paraqitjen nga ana e Koncesionarit te kërkesës dhe dokumentacionit përkatës.

c) Koncesionari ka te drejte te regjistrojë këtë Kontratë pranë ZVRPP për të garantuar të drejtat e tij mbi pronësinë e Shesheve dhe çdo parcele të Shesheve gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.

6.6. Veprimet e fazës para-ndërtimore dhe ndërtimore nën përgjegjësinë e Koncesionarit

6.6.1. Koncesionari duhet ti paraqesë Autoritetit Kontraktues, kërkesën për Leje Zhvillimore duke bashkangjitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar për në raste tilla, jo më vonë se 6 muaj pas Datës Efektive, me kushtin që Autoriteti Kontraktor ose Cdo Entitet Shtetëror, përfshirë Bashkinë Tiranë të kenë realizuar të plotë dhe pa të meta apo defekte procesin e Shpronësimit dhe Koncesionari të ketë marrë në dorëzim dhe të ketë akses të plotë mbi Sheshet.

6.6.2. Në rastin e Shpronësimeve, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, apo Entiteti Shtetëror përkatës që ka fituar titullin e pronësisë mbi parcelat e Shesheve të shpronësuar, informon menjëherë Koncesionarin mbi regjistrimin e titullit të pronësisë mbi parcelën / parcelat përkatëse dhe Koncesionari (nëse del e nevojshme) depoziton dhe regjistron menjëherë kopje të kësaj Kontrate pranë ZVRPP, me qëllim regjistrimin e të drejtave të tij Koncesionare mbi këto parcela.

6.6.3. Brenda 1 muaji nga data kur ka marre Lejet e Zhvillimore, Koncesionari fillon procedurat për t'i dorëzuar Autoritetit Kontraktues një raport mjedisor, social, shëndetësor, dhe sigurisë në kohën e duhur.

6.6.4. Brenda 12 muajsh nga data kur ka marrë Lejen Zhvillimore, Koncesionari paraqet, tek Autoriteti Kontraktues, Projektin e detajuar të Zbatimit.



6.6.5. Koncesionari, jo me vonë se 1 muaj nga data e fillimit të Punimeve, i dorëzon Autoritetit Kontraktues kopje të certifikatave të sigurimit që vërtetojnë se Koncesionari është pajisur me policat e detyrueshme të sigurimit dhe se është i mbuluar për të gjitha rreziqet e fazës së ndërtimit, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate.

6.6.6. Brenda 3 muajve nga data kur Koncesionari ka marrë të gjitha Leje/ Licensat, Autorizimet e nevojshme dhe Lejen Zhvillimore, Koncesionari njofton Autoritetin Kontraktor për lidhjen e kontratave me nënkontraktorët përkatës.

6.7. Marrëveshje të fazës para-ndërtimore dhe ndërtimore nën përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues

6.7.1. Autoritetit Kontraktues i dorëzon, pa pagesë, koncesionarit të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm që disponon për marrjen e Lejes Zhvillimore dhe të të gjitha Autorizimeve Lejeve dhe Licensave të tjera, brenda 2 muajsh nga kërkesa e Koncesionarit për dorëzimin e këtij informacioni.


6.7.2. Autoriteti Kontraktor, apo Entitetet Shtetërore i lëshojnë Koncesionarit të gjitha Autorizimet e nevojshme për fazën e ndërtimit, me kusht që Koncesionari të ketë paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara në kohën e duhur përfshirë, përgatitjen dhe dorëzimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Gjithashtu, Koncesionari do të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues, me kërkesën e këtij të fundit, korrespondencën zyrtare me çdo Entitet Shtetëror.

6.8. Fillimi i Fazës së Ndërtimit

6.8.1. Brenda 30 ditëve nga plotësimi i të gjitha kushteve të mëposhtme bashkërisht: (i) përfundimi i procesit të Shpronësimit dhe marrja në dorëzim nga Koncesionari i Shesheve; (ii) pajisja e Koncesionarit me Leje Zhvillimore; dhe (iii) marrja nga Koncesionari i të gjitha Autorizimeve / Lejeve dhe Licensave të nevojshme për fillimin e ndërtimit të Veprave nën Projekt, Koncesionari do të fillojë Ndërtimin e Veprave në përputhje me Grafikon e Punimeve ("**Data e Fillimit të Punimeve**"). Për hir të qartësisë afatet e përcaktuara në Grafikon e Punimeve fillojnë të ecin dhe si pasojë përlogariten në Ditën e Fillimit të Punimeve, pasi janë pëmbushur kushtet e përcaktuara në këtë paragraf.

6.8.2. Në diskrecionin e tij, por pasi ka njoftuar me shkrim Autoritetin Kontraktor, Koncesionari mund të fillojë fazën e ndërtimit për Vepra të caktuara përpara Datës së Fillimit të Punimeve, në rast vonesash për pajisje me Leje / Licensa apo Autorizime të caktuara për shkaqe jashtë kontrollit të Koncesionarit, përsa kohë Koncesionari është pajisur me Lejen Zhvillimore apo një leje të barazvlefshme me të, për Vepra të caktuara.

7. ÇMIMET / TARIFAT, FATURIMI DHE PAGESAT, SASIA MINIMALE E GARANTUAR DHE RAPORTIMI & AUDITIMI



7.1. Çmimet / Tarifat e pagueshme nën këtë Kontratë përbëhen nga dy (2) komponentë:

7.1.2 Tarifa në favor të Koncesionarit, që përbëhen nga:

- (i) Çmimi për Ton për Mbetje Urbane për Koncesionarin – i barabartë me EUR 29.00 (njëzet e nëntë Euro) pa TVSH, çmim i cili do të paguhet mbi baza mujore nga Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë në favor të Koncesionarit brenda 10 (dhjetë) ditëve të muajit pasardhës; dhe
- (ii) Pagesat që Koncesionari do të përfitojë nga shitja e Energjisë Elektrike të prodhuar nga Impianti i Përpunimit të Mbetjeve.

7.1.3. Tarifa Koncesionare në favor të Autoritetit Kontraktor

Tarifa Koncesionare do të përbëhet nga sasia e barabartë me 2.1% (dy pikë një përqind) të sasisë së prodhuar nga Koncesionari të energjisë elektrike nga Impianti i Përpunimit të Mbetjeve, në përputhje me Dokumentat Standarte të Procedurës Përzgjedhëse Konkuruuese.

7.2. Axhustimi i Çmimit / Ton Mbetje sipas Inflacionit

7.2.1. Në varësi të normës së inflacionit, Çmimi (Tarifa) / Ton Mbetje Urbane, e dhënë nga Koncesionari në Ofertën e tij, do të jetë subjekt rishikimi çdo 12 muaj, sipas formulës së mëposhtme:

$$T^{(2)} = T^{(1)}(1+NI)$$

- "T⁽²⁾" do të thotë tarifa e re që do të aplikohet në vitin korent.

- "T⁽¹⁾" do të thotë tarifa e aplikuar në vitin pararendës.

- "NI" do të thotë norma e inflacionit e vitit pararendës.

7.2.2. Në çdo rast, Çmimi (Tarifa) / Ton Mbetje, pavarësisht inflacionit nuk do të jetë poshtë / nën shifrën EUR 29.00 / ton Mbetje Urbane pa TVSH.

7.3 DETYRIMI PER SASI MINIMALE MBETJESH URBANE

7.3.1 Përgjatë të gjithë Kohëzgjatjes së kësaj Kontrate Autoriteti Kontraktor nëpërmjet Njësitë të Vendore të Qarkut Tiranë, garanton Koncesionarin në lidhje me furnizimin e tij me Sasinë Minimale të Garantuar të Mbetjeve Urbane.

7.3.2. Në rast se sasia e Mbetjeve Urbane të dorëzuara Koncesionarit është më pak se Sasia Minimale e Garantuar e Mbetjeve, atëherë Bashkia Tirane do t'i paguajë Koncesionarit diferencën mes vlerës totale të Çmimit për Ton Mbetje Urbane për sasinë e Mbetjeve Urbane dorëzuar Koncesionarit si me sipër dhe vlerës totale të Sasisë Minimale të Garantuar të Mbetjeve Urbane shumezuar me Çmimin për Ton Mbetje Urbane të percaktuar dhe perlllogaritur sipas këtij neni (Pagesa për Arritjen



e Sasise Minimale te Garantuar te Mbetjeve Urbane). Autoriteti Kontraktues do të ndërmarrë të gjithë veprimet e duhura brenda Ligjit për të garantuar këtë detyrim të Bashkisë Tiranë dhe detyruar këtë të fundit të përmbushë këtë detyrim ndaj Koncesionarit.

7.4. Faturimi nga Koncesionari dhe Pagesat në favor të Koncesionarit

7.4.1. Koncesionari duke filluar menjëherë nga Data Efektive e kësaj Kontrate dhe Dorëzimi i Venddepozitimit Ekzistues nga Bashkia Tiranë, do të faturojë Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë, mbi baza mujore në bazë të sasive të Mbetjeve Urbanë që do pranojë.

7.4.2. Fatura mujore e Koncesionarit do të përmbajë vlerën në para në monedhën Euro, që del si rezultat i sasisë mujore të Mbetjeve Urbane të pranuar nga Koncesionari për atë muaj kalendarik, që i shumëzohet Çmimit për Ton / Mbetje Urbane. Kësaj vlere do ti shohet edhe vlera e TVSH-së.

7.4.3. Faturat mujore të lëshuara nga Koncesionari, do të paguhet nga Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë brenda 10 (dhjete) ditëve të para të muajit pasardhës.

7.5. Raportimi Financiar dhe Auditimi

Një herë në vit, 90 ditë pas mbarimit të vitit financiar, por jo më vonë se 180 ditë e para të vitit, Koncesionari i paraqet Autoritetit Kontraktues, bilancet financiare të audituara.

8. MONITORIM I PERGJITHSHM I PUNIMEVE

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të ushtrojë mbikqyrje të përgjithshme, nëpërmjet NJZP-së (në përbërje të të cilit duhet të jenë specialistë të fushës të aftë të realizojnë supervizimin e Punimeve), gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë dhe se ecuria e Punimeve, cilësia dhe konformiteti i tyre, të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të Projektit, si dhe nëpërmjet supervisorit me raportet e tij 6 (gjashtë) mujore. Në rast të shkeljeve të Kontratës, të konstatuara gjatë monitorimit dhe mbikqyrjes së përgjithshme, Autoriteti Kontraktues do të njoftojë me shkrim Koncesionarin, për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre, për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara/pretenduara.

KREU III

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTOR

9. DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

9.1. Te mbajë të padëmtuar Koncesionarin për çdo Humbje Direkte ose Fitim të Munguar të pagueshëm Koncesionarit sipas kësaj Kontrate dhe/ose Ligjit dhe t'i



garantojë në tërësi Koncesionarit pagesat në kohë dhe pa vonesa të të gjitha Pagesave sipas Cmimeve dhe Tarifave të aplikueshme nën këtë Kontratë, ose ashtu sic mund të amendohen, apo indeksohen.

9.2. T'i paguajë Koncesionarit Pagesën për Arritjen e Sasisë Minimale të Garantuar të Mbetjeve Urbane sipas nenit 7.3. ketu me sipër, pavarësisht shkaqeve që kanë çuar në mos arritjen e Sasisë Minimale të Garantuar të Mbetjeve Urbane, me kusht që kjo të mos ketë ardhur për faj të Koncesionarit.

9.3. Në rast se Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë nuk i paguajnë Koncesionarit pagesat sipas Tarifave brenda afatit të përcaktuar në Nenin 7.4.3., Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë detyrohen t'i paguaje Koncesionarit menjëherë, (i) pagesën e plotë, ose (ii) pjesën e mbetur pa paguar të pagesës së plotë, sipas kërkeses së Koncesionarit, dhe në rast se këto pagesa nuk kryhen brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkeses nga ky i fundit, Koncesionari ka të drejtë të pezullojë marrjen dhe depozitimimin e Mbetjeve nga Njesia Vendore e Qarkut Tirane debitore ndaj tij, deri në shlyerjen e plotë të pagesës përkatëse konform nenit 7.4.

9.4. Në rast se në përfundim të periudhës mujore përkatëse të faturimit, Njesia Vendore e Qarkut Tirane nuk i ka dorëzuar Koncesionarit Sasinë Minimale të Garantuar të Mbetjeve Urbane, Koncesionari do të leshojë faturen tatimore për Bashkinë Tirane e cila detyrohet t'i paguaje Koncesionarit sipas nenit 7.3 ketu me sipër Pagesën për Arritjen e Sasisë Minimale të Garantuar të Mbetjeve Urbane; dhe në rast vonese në pagesë do të aplikohet një penaltet mujor prej 1% (një përqind) i përlogaritur mbi shumën e Pagesës për Arritjen e Sasisë Minimale të Garantuar të Mbetjeve Urbane Pagesen sipas pikës (i) të këtij paragrafi.

9.5. Me kërkesën e Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues ndihmon, në lidhje me këtë Projekt Koncesionarin ose nënkontraktorët e tij dhe lëshon ose bën të mundur që Enti Shtetëror kompetent të japë dhe rinovojë të gjitha Autorizimet dhe/ose Lejet/Licensat e nevojshme, me kusht që Koncesionari:

- a) të veprojë brenda kuadrit ligjor;
- b) të realizojë brenda Grafikut të Punimeve, Punimet sipas Projektit të Zbatimit dhe të përmbushë kriteret për mbajtjen e çdo Autorizimi;
- c) të informojë, në momentin e kërimit të një autorizimi apo rinovimit të tij, Autoritetin Kontraktues për të gjitha masat e marra dhe veprimtaritë e kryera për këtë qëllim; dhe
- d) t'i japë Autoritetit Kontraktues informacionin që ky mund të kërkojë, në rastin kur Koncesionari kërkon të shesë energji elektrike me qëllim që ky të lejojë Koncesionarin të shesë energji elektrike në rastet kur ka gjetur blerësin vetë, duke respektuar Ligjin në fuqi për këto veprimtari.
- e) Të sigurojë vazhdimësinë e kësaj Kontrate pavarësisht ndryshimeve të subjekteve apo objektivave të përpunimit të

Mbetjeve Urbane dhe/ose të Sektorit Elektro-energjitik Shqiptar.



9.6. Me kërkesë të Koncesionarit merr përsipër të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndihmuar këtë të fundit tek Entitetet Shtetërore për çdo pengesë që mund të haset në kuadër të pajisjes me leje, licenca, autorizime apo çdo lloj tjetër leje që nevojitet për ekzekutimin e punimeve dhe operimin e këtij Projekti, për permbushjen e të drejtave të Koncesionarit sipas kësaj Kontrate ose të cdo të drejte dhe perfitimi tjetër të ligjshëm që lidhet me të drejtat e Koncesionarit që burojnë nga kjo Kontrate, pasi të ketë komunikuar me shkrim me të gjitha entet dhe institucionet për listat e dokumenteve mënyrën dhe përmbajtjen që duhet të kenë. Për përmbushjet ligjore Koncesionari duhet të ruajë korrespondencën zyrtare me çdo autoritet shtetëror. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm kur mospajisja me leje, licencë, autorizim, etj, vjen si rezultat i mospërmbushjes së kërkesave ligjore nga ana e Koncesionarit

9.7. Të miratojë Projektin e Zbatimit të ndërtimit të Veprave, pjesë e Projektit dhe përpunimit të Mbetjeve, të përgatitur nga vetë Koncesionari, në përputhje me Ofertën e shpallur fituese në procedurën e konkurimit, në përputhje me Nenin 2.2.4. këtu më sipër në këtë Kontratë.


9.8. Të ndihmojë e asistojë Koncesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me Entitete Shtetërore për qëllime të realizimit të Objektivit të kësaj Kontrate, përfshirë edhe mundësimin në të ardhmen edhe të subjekteve të treta private ose vete Entitete Shtetërore të depozitojnë Mbetjet e tyre tek Koncesionari, kundrejt cmimit për ton Mbetje që do të përcaktohet në bazë të kostos së Koncesionarit për përpunimin e tyre.

9.9. Të garantojë Koncesionarin se Autoriteti Kontraktor nuk do të kërkojë ndërprerjen e punimeve për zbatimin e Objektivit të Kontratës, nëse kërkohet ndryshim / modifikim i Projektit me qëllim përdorimin e ndonjë teknologjie më të avancuar që konsiston në ndonjë shtesë për përmirësimin e tij.

9.10. Është përgjegjës për detyrimet ligjore dhe kontraktore në rast të mospërmbushjes së këtyre detyrimeve nga ana e tij duke shpërblyer të gjitha dëmet e shkaktuara Koncesionarit për shkak të shkeljes së Kushteve të përcaktuara në Kontratë.

9.11. Mbi të gjitha Autoriteti Kontraktor është përgjegjës për mbështetjen që Koncesionari do marrë nga Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë, në lidhje me furnizimin e pandërprerë me Mbetje Urbane nga këto Njësi dhe detyrimin e operatorëve respektivë të kontraktuar nga Njësitë Vendore të Qarkut Tiranë për të respektuar parashikimet e kësaj Kontrate, çka përbën një kusht thelbësor të kësaj Kontrate.

9.12. Të garantojë investimet publike pranë veprave, duke përfshirë por pa u kufizuar në rrugët, urat lidhëse, rjetet, etj. dhe të garantojë furnizimin e Koncesionarit me ujë, energji elektrike.



9.13. Te ndihmojë dhe asistojë Koncesionarin për çdo kërkesë të këtij të fundit, përfshirë mbështetjen për perlogaritjen dhe pagesën e çdo takse, tatimi, tarife, etj. në mënyrën me avantazhuese të mundshme për Koncesionarin, brenda kufijve të Ligjit, përfshirë por pa u kufizuar në taksën e ndikimit në infrastrukture në përputhje me Punimet e Ndërtimit sipas Lejes së dhënë për çdo Lot/Modul/Veprë, fazë Projekti apo në tërësi, sipas parashikimeve të kësaj Kontrate.

9.14. Të detyrojë Njësitet e Qeverisjes Vendore të Qarkut Tiranë që përveçse të mbulojnë kostot e transportit të Mbetjeve, sipas Ligjit përkatës, për t'iu dorëzuar Koncesionarit sipas kësaj Kontrate, të ulin kostot e trajtimit të Mbetjeve me anë të teknikave dhe teknologjive të ndryshme, përfshirë por pa u kufizuar në depozitim dhe sistemin e Mbetjeve duke mundësuar uljen e volumit të tyre duke i transportuar në stacione transferimi Mbetjesh.

9.15 Autoriteti Kontraktor garanton Koncesionarin se ky i fundit, me qëllim rritjen e rentabilitetit/maksimalizimit të investimeve, ka të drejtë të marrë dhe të furnizohet me Mbetje edhe nga njësi vendore të qarqeve të tjera ose persona të treta private ose publike, për atë sa kjo nuk cenon përmbushjen e detyrimeve që Koncesionari ka sipas kësaj Kontrate.

KREU IV

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT

10.DETYRIMET E KONCESIONARIT

10.1.Koncesionari është përgjegjës ndaj Autoritetit Kontraktues për përmbushjen e detyrimeve që i janë atribuar atij sipas kësaj kontrate.

10.2.Garancitë

10.2.1.Koncesionari zbaton çdo procedurë të nevojshme ligjore për rikthimin e të drejtave të koncesionit mbi Veprat pas përfundimit të kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.

10.2.2.Të marrë të gjitha Autorizimet, Lejet dhe Licencat e nevojshme për realizimin e kësaj Kontrate në përputhje me Ligjin shqiptar në fuqi.

10.2.3.Të marrë masa që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuara dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë;

10.2.4 Të zbatojë Projektin për ndërtimin e Veprave dhe vecanërisht të Impiantit të Përpunimit të Mbetjeve Urbane me fuqi totale të vendosur deri në 18 MW.

10.2.5.Të administrojë Venddepozitimet dhe Impiantet dhe në tërësi të gjitha Veprat dhe Veprat Plotësuese për Periudhën e Koncesionit.



10.2.6. Të parandalojë dhe kontrollojë çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë punim i tij dhe të kthejë ambientin, me shpenzimet e veta, në situatën e mëparshme (para ndotjes së shkaktuar nga Koncesionari, nëse ka të tilla).

10.2.7. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventalisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues nëse këto vijnë si pasojë e veprimeve të tij.

10.2.8. Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e Projektit, apo shtyerjen e afateve të Grafikut të Punimeve.

10.2.9. Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjenës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.

10.2.10. Koncesionari nuk duhet të ndërhyjë në burimet ujore që furnizojnë ujësjellësin e zonës, përvec rastit kur ka miratim paraprak nga shoqëria përgjegjëse e ujësjellës-kanalizimeve e Bashkisë Tiranë.

10.2.11. Koncesionari duhet të marrë masa për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit në fuqi për ruajtjen e ekosistemit natyror.

10.2.12. Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi.

10.2.13. Në kuadër të zbatimit të punimeve për realizimin e projektit, bazuar në legjislacionin dhe aktet nënligjore për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim, Koncesionari është i detyruar të emërojë një subjekt në rolin e mbikëqyrësit të punimeve. Ai mund të jetë person fizik, juridik, vendas apo i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i cili do të paraqitet për miratim pranë Autoritetit Kontraktues.

10.2.14. Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale.

10.3. Ndërtimi i Veprave

10.3.1. Projektimi

Projekti i detajuar përgatitet në përputhje me përcaktimet e Aneksit VIII

10.3.2. Ndërtimi

10.3.2.1. Koncesionari do të ndërtojë apo rehabilitojë Veprat, sipas Projektit të detajuar dhe në përputhje me Praktikat më të mira Industriale.

10.3.2.2. Veprat do të ndërtohen brenda afateve të Ofertës së paraqitur në Procedurën Konkurruese si edhe të përcaktuara nga Palët në këtë Kontratë.



10.3.2.3. Përveçse kur në këtë Kontratë parashikohen shkaqe të arsyeshme, apo për shkaqe jashtë kontrollit të Koncesionarit, nëse Koncesionari dështon në përfundimin e fazave të ndërtimit brenda afateve të përcaktuar në Grafikon e Punimeve, ashtu siç ai mund të jete ndryshuar nepermjet Projektit të Zbatimit, ne perputhje me nenin 2.2.4. ketu me sipër, Koncesionari është i detyruar t'i paguajë penaltetet Autoritetit Kontraktor sipas kesaj Kontrate.

10.3.3.4. Totali i dëmeve të likuidueshme kufizohet në vlerën e sigurimit të Kontratës.

10.3.3.5. Koncesionari nuk është i detyruar të dëmshpërblejë për të njëjtin dëm dy përfitues të ndryshëm.


10.3.3.6. Koncesionari është përgjegjës për ndërtimin e të gjitha rrugëve të nevojshme hyrëse, nga rrjeti ekzistues rrugor shqiptar në Shesh.

10.3.3. Rrethana të veçanta gjatë fazës së ndërtimit, zgjatja e afatit të përfundimit të punimeve

Data e planifikuar e Përfundimit të Punimeve për secilën Vepër veçmas, apo për Projektin në tërësi do të zgjatet, pa mbajtur përgjegjës Koncesionarin dhe pa aplikimin e asnjë penalteti apo kërkesë për dëmshpërblim nga Autoriteti Kontraktues, ne rastet kur:

- a) ka ndodhur një ngjarje e Forcës Madhore dhe data e caktuar e përfundimit të punimeve zgjatet për një periudhë kohore të barabartë me vonesën e shkaktuar nga Forca Madhore;
- b) ligjvënësi nxjerr akte ose kryen veprime të cilat ndikojnë në shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, atëherë data e parashikuar për përfundimin e punimeve zgjatet për një periudhë kohore të barabartë me vonesën e shkaktuar nga veprime ose akte të tilla.
- c) relike arkeologjike, kulturore, fosile, varreza dhe përkujtimore, mbetje artistike historike apo objekte të tjera, ose sende të tjera me rëndësi arkeologjike, gjeologjike ose historike, janë zbuluar në, ose rreth Sheshit, dhe këto zbulimeve shkaktojnë vonesa në përfundimin e punimeve, data e parashikuar përfundimin e punimeve do të zgjatet për një periudhë kohore të barabartë me kohëzgjatjen e vonesës për këto shkaqe.
- d) lind një mosmarrëveshje në lidhje me këtë nen, e cila zgjidhet sipas mekanizmave të parashikuara në këtë kontratë.
- e) për çfarëdo arsye nuk ka përfunduar procesi i Shpronësimit për të gjitha parcelat e Shesheve.

Në asnjë rast, kur zgjatja e afateve bëhet për shkaqet e listuara në nenin 10.3.3, sa më sipër, Autoriteti Kontraktor nuk mund të mbajë përgjegjës Koncesionarin dhe nuk mund të kërkojë apo aplikojë asnjë penalitet, apo kërkesë për dëshperblim kundrejt këtij të fundit.



10.4. Detyrat e tjera

Koncesionari duhet:

- a) të vendosë në dispozicion kopje të çdo skice dhe dokument projektimi nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues apo përfaqësuesi i tij;
- b) t'i sigurojë projektet dhe dokumentet e tjera Autoritetit Kontraktues në përputhje me këtë kontratë;
- c) parandalojë dhe kontrollojë ndotjen e ambientit që mund të shkaktohet nga kryerja e punimeve;
- d) të marrë të gjitha masat mbrojtëse të nevojshme në lidhje me Sheshet dhe impiantet
- e) të trajtojë Mbetjet Urbane Objekt i Kontratës, nëpërputhje me Ligjin shqiptar dhe Praktikrat më të mira Industriale;
- f) të mos shkaktojë dëmtime të tubacioneve ekzistuese në Sheshe, kablllove apo përçuesve në Sheshe, ekzistenca e të cilave ka qenë e njoftuar në menyre të rregullt nga Autoriteti Kontraktues, përveç se me miratim të Autoritetit Kontraktues.

10.5. Vlera e Investimit të

10.5.1. Mbi bazën e Ofertës së paraqitur nga Koncesionari në procedurat konkurruese, vlera e Investimit do të jetë sipas për cdo fazë / Lot,

10.5.2. Në varësi të optimizimit të Projektit, Koncesionari mund të përfshijë brenda të njëjtës vlerë Investimi edhe kostot në lidhje me Veprat Plotësuese, sipas dispozitave të kësaj Kontrate.

10.5.3. Vlerësimi i Investimit si më sipër mund të pësojë ndryshime me marrëveshje ndërmjet palëve:

- a. pas variantit përfundimtar të Projektit të Zbatimit i cili mund të përmirësohet duke patur parasysh percaktimet e nenit 2.2.4 të kësaj Kontrate; ose
- b. në çdo kohë gjatë zbatimit të Projektit;

10.6. Grafiku i Punimeve

Grafiku i detajuar i Punimeve gjendet bashkelidhur kësaj Kontrate si Aneksi IV i saj dhe afatet e tij fillojnë në Datën e Fillimit të Punimeve.

10.7. Testimi i Veprave



10.7.1. Testi i vënies në punë (performancës)

10.7.1.1. Koncesionari njofton me shkrim Autoritetin Kontraktor të paktën pesëmbëdhjetë ditë përpara, për datën dhe orën në të cilën do të fillojë testi i vënies në funksionim i çdo Veprë.

10.7.1.2. Nëse Autoriteti Kontraktues ose i emëruari prej tij, nuk janë të pranishëm në kohën e caktuar, Testi i Performancës mund të kryhet në mungese të tyre dhe për rezultatet dërgohet njoftim me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga testimi dhe vënia në punë.

10.7.2. Raporti përfundimtar dhe Çertifikata përfundimtare

- a) Brenda 30 ditëve nga përfundimi i të gjithë testeve të performance/vënies në punë/komisionimit për çdo Impiant, Koncesionari i dorëzon Autoritetit Kontraktues Raportin Përfundimtar.
- b) Nëse ndërkohë nuk është lëshuar asnjë njoftim dështimi, Autoriteti Kontraktor lëshon Çertifikatën Përfundimtare jo më vonë se 30 ditë pas dorëzimit të Raportit Përfundimtar. Nëse Autoriteti Kontraktor nuk lëshon një Çertifikatë Finale Përfundimi dhe nuk arrin të lëshojë as edhe një njoftim dështimi, në secilin rast brenda 30 ditëve nga dorëzimi i Raportit Përfundimtar, Çertifikata Përfundimtare konsiderohet e lëshuar për Veprën respektive.

10.8. Detyrimet pas Përfundimit të Punimeve

Jo më shumë se 30 ditë pas Datës së Përfundimit të Punimeve, Koncesionari duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues:

- a) dy kopje me të gjitha të dhënat teknike (përfshirë edhe raportin e projektimit, llogaritjen dhe dokumentet e projektimit, si në letër ashtu dhe në formë elektronike, duke përfshirë të gjitha udhëzimet e përshtatshme) në lidhje me projektimin dhe ndërtimin e Veprave;
- b) dy kopje të skicave të impianteve "siç janë ndërtuar", së bashku me të dhënat që lidhen me secilën provë për vënien në punë dhe Çertifikatën Përfundimtare për çdo Vepër, dhe
- c) dy kopje të çdo dokumenti tjetër teknik ose materiale të tjera në lidhje me Veprat siç mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.

10.9. Braktisja

Realizimi i Projektit do të konsiderohet i braktisur nga Koncesionari nëse, pa miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues, koncesionari:

- a) Njofton Autoritetin Kontraktues rreth vendimit të tij të braktisjes të të gjitha ose një pjese të Punimeve në lidhje me atë Vepër;

2



- b) nuk rifillon, në tërësi ose pjesërisht, Punimet në lidhje me atë impiant brenda 180 ditëve nga përfundimi i një ngjarjeje të Forcës Madhore;
- c) ndalon pa asnjë arsye, ndërtimin e të gjitha Punimeve thelbësore në Vepër për një periudhë më të gjatë se 180 ditë, ose
- d) tërheq nga Sheshi, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet veprimeve të ndërmarra nga ndonjë kontraktor për ndërtimin, të gjithë apo pjesën më të madhe të personelit, para datës së parashikuar për Përfundimin e Punimeve dhe:
- e) një tërheqje e tillë çon në ndalimin e plotë të Punimeve;
- f) një ndalim i tillë, sipas gjykimit të arsyeshëm, nuk është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e personelit.

Data e braktisjes do të konsiderohet, në lidhje me pikën a) si më sipër, data në të cilën është marrë njoftimi, dhenë lidhje me pikat b) deri d), më sipër, data në të cilën përfundojnë njëqind e tetëdhjetë ditët e përmendura.

10.10. Funksionimi dhe mirëmbajtja

10.10.1. Vënia në punë

Pas Përfundimit Paraprak të një Vepre, Koncesionari ka të drejte të:

- a) të ushtrojë të gjitha të drejtat Koncesioneve, në përputhje me Praktikat e mira Industriale dhe të përmbushë kërkesat teknike minimale;
- b) të verë në funksion dhe të mirëmbajë Veprat të përcaktojë dhe zbatojë një regjim të planifikuar të mirëmbajtjes në përputhje me Praktikat e mira Industriale;

10.10.2 Raportimi

Koncesionari është i detyruar që çdo 90 ditë të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të Investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

KREU V


DISPOZITA TE TJERA

11. ZGJIDHJA E KONTRATËS SË KONCESIONIT

11.1. Mospërmbushjet nga Koncesionari.

Do të konsiderohen si mospërmbushje të detyrimeve nga ana e Koncesionarit, të Kontratës vetëm rastet kur:


- i. Koncesionari ka shpallur pa-aftësinë paguese;
- ii. Koncesionari braktis Projektin;

- 
- iii. Koncesionari kryen shkelje thelbësore të kushteve të kësaj Kontrate në rastet kur shkelja ka vazhduar për më shumë se 180 dite pas njoftimit nga Autoriteti Kontraktues për një shkelje të tillë;
 - iv. Koncesionari nuk fillon punën për faj të tij brenda 180 ditëve nga Data e Filimit të Punimeve të Ndërtimit, dhe pasi janë marrë në favor të tij, të gjitha Lejet Zhvillimore, Autorizimet, Lejet / Licensat e aplikueshme, dhe ka përfunduar i plotë dhe pa të meta Shpronësimi. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontrates, ose
 - v. Koncesionari transferon kuotat e tij, pa miratim të Autoritetit Kontraktues.

Nuk zbatohet ky nen kur rastet e mësipërme janë shkaktuar nga një Veprim Shtetëror Thelbësisht në kundërshtim me Kontratën, nga mospërbushje e detyrimeve nga ana e Autoritetit Kontraktues apo nga ngjarje të Forcës Madhore.

11.2. Mospërbushjet nga Autoriteti Kontraktues.

Do të konsiderohen si mospërbushje të detyrimeve të Kontrates, vetem rastet nëse:

- a) Një Entitet Shtetëror pengon, shpronëson, konfiskon apo shtetëzon:
 - i. kuota në SPV-në ose ndonjë nga ortaket;
 - ii. asete materiale apo të drejta të Koncesionarit;
 - iii. çdo akt tjetër i ndonjë organi shtetëror që ndikon negativisht në:
 - gëzimin e të drejtave dhe përfitimeve të parashikuara nga kjo Kontratë, nga ana e Koncesionarit;
 - përbushjen e detyrimeve të kësaj Kontrate nga ana e Koncesionarit;
 - funksionimin dhe mirëmbajtjen e Impianteve dhe prodhimin e energjisë elektrike; ose
 - gëzimin e të drejtave dhe përfitimeve nga ndonjëortak, si rezultat i kuotave të Koncesionarit.
 - b) Koncesionari nuk është në gjendje të përbushë të gjitha ose një pjesë të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate për shkak të një Veprimi Shtetëror Thelbësisht në kundërshtim me Kontraten që ka vazhduar për më shumë se 180 ditë rresht; ose
- 



- c) Autoriteti Kontraktues ose ndonjë Entitet tjetër Shtetëror nuk vë në dispozicion të Koncesionarit, Sheshet ne perputhje me te Drejtat e Koncesionit, sipas afateve te nenit 6.5. te kesaj Kontrate; ose
- d) Autoriteti Kontraktues ose ndonjë Entitet tjetër Shtetëror, pas dorëzimit të dokumentacionit ligjor të kërkuar nga Koncesionari, nuk arrin t'i japë koncesionarit Lejen Zhvillimore dhe/ose ndonjë Autorizim, Leje / Licensa brenda afatit te percaktuar nga neni 5.8 dhe/ose ne teresi çdo autorizim tjetër të nevojshëm brenda afateve kohore, të përcaktuara në këtë Kontrate; ose
- e) Autoriteti Kontraktues ose ndonjë Entitet tjetër Shtetëror nuk i kanë dhënë, zbatuar, garantuar ose bere te mundur/efektive te Drejtat e Koncesionit sipas neneve 5.1., 5.2.1., 5.4., 5.5.2, 6.4.1. dhe 6.5. te kesaj Kontrate; ose
- f) Autoriteti Kontraktues ose ndonjë Entitet tjetër Shtetëror nuk kane kryer Shpronësimet brenda afatit te percaktuar ne nenet 5.7. dhe 6.5.3, ose pavaresisht veprimeve te tyre, Entiteti Shteteror pergjegjes nuk ka regjistruar te drejtat reale te Koncesionarit brenda afateve Ligjore; ose
- g) Koncesionari ka pesuar Humbje Direkte ose Fitim te Munguar per shkak te mospermbushjes se angazhimeve, premtimeve, garancive ose detyrimeve te Autoritetit Kontraktues ose te ndonje Entiteti Shteteror sipas kesaj Kontrate; ose
- h) Koncesionari nuk ka filluar Punimet brenda 24 muajve nga Data Efektive jo per faj te tij, pavarësisht nëse është pajisur ose jo me Lejet / Licensat, Autorizimet përkatëse dhe/ose Lejen Zhvillimore; ose
- i) Koncesionari nuk ka filluar te operoje Impiantet brenda 36 muajsh nga Data Efektive, jo për faj të tij;
- j) Koncesionarit nuk i është garantuar dhe nuk ka marrë Sasinë Minoriale të Garantuar te Mbetjeve Urbane, për një periudhe prej 45 (dyzet e pesë) ditësh përgjatë një periudhe 5 vjecare;
- k) Autoriteti Kontraktues kryen shkelje të tjera apo nuk përmbush detyrimet, sipas kësaj Kontrate dhe këto shkelje kanë vazhduar për më tepër se 180 ditë pas njoftimit të dhënë nga Koncesionari për shkeljen nga Autoriteti Kontraktor.

Ky nen nuk zbatohet kur rastet e mësipërme janë shkaktuar nga ngjarje të Forcës Madhore.

11.3. Forca Madhore e Tezgjatur.

Secila palë ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontrate duke njoftuar me shkrim Palën tjetër, nëse asnjë nga Palët nuk është në gjendje të kryejë të gjitha ose një pjese të detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, për shkak të një ngjarjeje të zgjatur te Forcës Madhore, me kushtin që Autoriteti Kontraktues nuk e zgjidh dot këtë Kontratë, nëse



Koncesionari është duke riparuar dëmet e shkaktuara si rezultat i ngjarjes së Forcës Madhore.

11.3.1. Njoftimet me shkrim të kryera nga Autoriteti Kontraktues, apo Koncesionari, në përputhje me kete paragraf 11.3 te ketij neni më sipër, kanë si efekt:

- a) Zgjidhjen e Kontrates në mënyrë të menjëhershme, nëse nuk është parashikuar një datë specifike, nëse situata nuk mund të korrigjohet; ose
- b) Zgjidhjen e kësaj kontrate pas kalimit të një periudhe 60-ditore, me përjashtim të rasteve kur Pala që ka shkaktuar mospërmbushjen, para mbarimit të kësaj periudhe; ose
- c) eliminon mospërmbushjen, ose:
- d) i paraqet Palës tjetër një program masash korrigjuese brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, dhe e zbaton këtë program brenda 30 ditëve nga dita kur Pala tjetër jep pëlqimin.

11.3.2. Njoftimet me shkrim të kryera nga Autoriteti Kontraktues, apo Koncesionari në përputhje me paragrafin 11.3.1. ketu me sipër sjell zgjidhjen e kësaj Kontrate sipas parashikimeve te ketij paragrafi 11.3 te ketij neni.

11.3.3. Kur Koncesionari zgjidh këtë Kontratë para fillimit të fazës së ndërtimit sipas sipas parashikimeve te ketij paragrafi 11.3 te ketij neni dhe/ose për mospërmbushje të detyrimeve nga Autoriteti Kontraktues, Autoriteti Kontraktues është i detyruar të paguajë të gjitha Investimet dhe shpenzimet e kryera nga Koncesionari, deri në atë fazë dhe Koncesionari është i detyruar t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues të gjithë dokumentacionin e Projektit, përfshirë studime, vëzhgime, etj.

11.3.4. Kur Koncesionari zgjidh këtë Marrëveshje për mospërmbushje të detyrimeve nga Autoriteti Kontraktues sipas sipas parashikimeve te ketij paragrafi 11.3 te ketij neni (i) në qoftë se zgjidhja ndodh pas fillimit të fazës së ndërtimit, por përpara Datës së Përfundimit të Punimeve, Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit, për transferimin e Impianteve dhe të gjitha të drejtave që lidhen me to dhe të aseteve Autoriteti Kontraktues, në gjendjen "siç janë", në përputhje me këtë Kontratë, një vlerë të barabartë me shumën e (a) Kosto Aktuale të Investimeve, plus (b) çdo shpenzim tjetër që i shkaktohet Koncesionarit, si rezultat i zgjidhjes së kësaj Kontrate, përfshirë kostot për zgjidhjen e kontratave me punonjësit dhe shpenzimet që duhet t'u paguhen kontraktorëve, ose (ii) nëse zgjidhja ndodh pas Datës së Përfundimit të Punimeve, shuma e llogaritur e Kosotos Aktuale të Investimeve, sipas (a) më sipër reduktohet 2,86% për çdo vit të plotë në të cilin ndodh zgjidhja e Kontratës.

11.3.5. Në rastet kur secila Palë zgjidh këtë Kontratë pas fillimit të fazës së ndërtimit për ngjarje të Forcës Madhore të Tejzgjatur, Autoriteti Kontraktues duhet t'i paguajë Koncesionarit për transferimin e Impianteve, të drejtave dhe aseteve, në gjendjen "siç janë", si më poshtë, (i) nëse zgjidhja ndodh pas fillimit të fazës së ndërtimit, por përpara Datës së Përfundimit të punimeve, një shumë të barabarte me shpenzimet e

investimit (duke zbritur të ardhurat e përfituara nga kontratat e sigurimit nëse ka), ose (ii) nëse zgjidhja ndodh pas Datës së Përfundimit të Punimeve, një shumë të barabartë me shpenzimet e investimit (duke zbritur të ardhurat e përfituar nga kontratat e sigurimit nëse ka), me kusht që kjo shumë do të reduktohet nga 2,86% përçdo vit të plotë pas Datës së Përfundimit të Punimeve.

11.3.6. Transferimet e Veprave, të drejtave dhe asetëve sipas paragrafeve të mësipërm te ketij neni ketu do të kryhen njëkohësisht me transferimin e pagesave përkatëse, brenda 90 ditëve nga zgjidhja e kësaj Kontrate.

11.3.7. Me zgjidhjen e kësaj Kontrate sipas paragrafeve të mësipërm te ketij neni ketu, të drejtat, titujt dhe interesat e Koncesionarit transferohen te Autoriteti Kontraktues dhe çdo Leje, Licence apo Autorizim quhet i pavlefshëm dhe Koncesionari është i detyruar të dorëzojë gjithë dokumentacionin që lidhet me Projektin.

Asnjëra nga Palët nuk mund ta zgjidhë këtë Kontrate përveç se ashtu siç parashikohet në këtë Kontratë.

11.4. Zgjidhja e njëanshme e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

11.4.1. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë Kontratën vetem në rast se ndodh një nga rastet e nenit 11.1 më sipër, pasi Autoriteti Kontraktor e ka njoftuar paraprakisht me shkrim Koncesionarin për shkeljen e pretenduar dhe Koncesionari nuk e korrigjon këtë shkelje brenda afatit të përcaktuar në nenin 11.6 ketu më poshtë.

11.4.2. Zgjidhja e njëanshme e Kontratës nuk çliron Koncesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e detyrimeve që kanë të bëjnë me dorëzimin e gjendjes faktike të realizimit të Punimeve tek Autoriteti Kontraktues. Palët bien dakord që dorëzimi do të bëhet brenda një afati kohor prej 180 (një qind e tetëdhjetë) ditësh duke filluar nga momenti i zgjidhjes së Kontratës.

11.4.3. Nëse ky detyrim nuk përmbushet nga Koncesionari atëherë, Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e Veprave për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë.

11.5. Zgjidhja e njëanshme e Kontratës nga Koncesionari.

Koncesionari ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë vetem në rast se ndodh një nga rastet e nenit 11.2 më sipër, pasi Koncesionari e ka njoftuar paraprakisht me shkrim Autoritetin Kontraktues për shkeljen dhe Autoriteti Kontraktues nuk e korrigjon këtë shkelje brenda afatit të përcaktuar në nenin 11.6 ketu më poshtë.

11.6. Njoftimi i zgjidhjes së Kontratës

Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e kësaj Kontrate në përputhje me paragrafet perkatese 11.4. dhe 11.5. te ketij neni ketu më sipër, do të njoftojë paraprkisht me shkrim Palën tjetër. Njoftimi duhet të përmbajë:

- a) Detajet e duhura duke nënvizuar shkakun e zgjidhjes;
- b) Datën e përfundimit të Kontratës, në rast të moskorrigjimit të shkeljes brenda 180 (një qind e tetëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit;
- c) Hollësitë e llogaritjes së pagesave si rezultat i zgjidhjes së Kontratës;
- d) Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

11.7. Zgjidhja e Kontratës me konsensus

Palët kanë të drejtë ta zgjidhin Kontratën me pëlqim të dyanshëm, duke negociuar mënyrën e kompensimit të investimit. Gjithësesi, Koncesionari ka të drejtë të kërkojë kthimin e Sigurimit të Kontratës nëse ekziston.

11.8. Pasojat e zgjidhjes se Kontrates

11.8.1. Pagesat per zgjidhjen e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues për faj të Koncesionarit.

Në rast të zgjidhjes së Kontratës për faj të Koncesionarit, sipas paragrafit 11.4.1. të këtij neni, Autoriteti Kontraktues i paguan Koncesionarit vlerën e plotë të Investimit të kryer deri në çastin e zgjidhjes.

11.8.2. Pagesat per zgjidhjes së kontratës kundrejt Koncesionarit për faj apo mospërmbushje të Autoritetit Kontraktues.

Në rast të zgjidhjes së Kontratës sipas paragrafit 11.5, për faj apo Mos-përmbushje të Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues duhet që brenda 60 ditëve të paguajë Koncesionarit: (i) vlerën e Investimeve të kryera deri në datën e zgjidhjes së Kontratës, (ii) cdo Humbje Direkte te pesuar, si edhe (iii) Fitimin e Munguar të cilin Koncesionari mund ta përfitonte deri në fund të Periudhës së Koncesionit.

12. TË DREJTAT E INSITUCIONEVE FINANCIARE / HUADHENESVE

12.1. Zëvendësimi i Koncesionarit

Njoftimi i Palës Financuese/Huadhenesit për shkeljet bëhet menjëherë pas marrjes dijeni për shkelje serioze nga ana e Koncesionarit të detyrimeve kontraktore, që çenojnë zbatimin dhe Operimin e Projektit ose sjellin si pasojë zgjidhjen e Kontratës. Autoriteti Kontraktues përveç njoftimit të Koncesionarit sipas nenit 11.6 të ketij neni, njofton edhe Palën Financuese me qëllim dhënien e një mundësie, kësaj të fundit, për të ndihmuar Koncesionarin për të korrigjuar ose marrë masa për të rregulluar këto shkelje brenda 180 ditësh nga data e një njoftimi të tillë. Autoriteti Kontraktues i jep Palës Financuese ndihmesë të arsyeshme për këtë qëllim.

12.2. Te drejtat dhe veprimet e Institucionet Financiare / Huadhënesit

12.2.1. Në rast se nuk është bërë i mundur korrigjimi i shkeljes nga Koncesionari, Institucionet Financiare / Huadhënësit (nëse e gjykon me interes) zgjedh, të ndërhyjë duke i propozuar Autoritetit Kontraktues, transferimin e Projektit në duart e një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues i cili duhet që të ketë, ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjëndjen financiare të paktën të barazvlershme me atë të Koncesionarit ne momentin e fitimit te gares.

12.2.2. Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues nuk do të pengojë apo vonojë pa arsye, pëlqimin e tij dhe do të bëjë ato veprime që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash.

12.2.3. Zëvendësuesi, do të ketë të drejtën e menaxhimit/administrimit të Projektit dhe do të realizojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit, por nuk do të ketë të drejtë të disponoje ose te krijojë te drejta reale mbi pasurite e paluajtshme te lidhura me/ne funksion te Projektit.

12.2.4. Nëse Insitucionet Financiare /Huadhenesi vendos të mos ushtrojë të drejtat e parashikuara në këtë nen, ose nëse edhe pas ushtrimit të këtyre të drejtave nuk arrihet në një zgjidhje të arsyeshme për vashdimësinë e Projektit brenda 12 muajsh nga casti i nderhyrjes se Insitucioneve Financiare / Huadhenesit sipas paragrafit 11.8.1. te ketij neni, Kontrata do të konsiderohet e zgjidhur.

13. KONTRATAT

13.1. Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të Projektit dhe çdo lloj kontratë tjetër, me qëllim realizimin e Objektivit të koncesionit. Në të gjitha kontratat, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate.

13.2. Koncesionari duhet të pajisë Autoritetin Kontraktues me informacionin e mëposhtëm për atë nën-kontraktues të propozuar vlera e kontratës të së cilit përfaqëson të paktën 30 % të Investimit sipas Projektit:

- 1.1.1 Emrin e tij dhe adresën;
- 1.1.2 Qëllimet për të cilat nën-kontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nën-kontraktuesi i propozuar; dhe
- 1.1.3 Vlerën e nënkontratës
- 1.1.4 Çdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.

13.3. Koncesionari është përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktues, për përmbushjen e detyrimeve nga ana e nën kontraktuesit.

13.4. Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

14. SIGURIMI I KONTRATËS

14.1. Koncesionari, para nënshkrimit të Kontratës, duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose të ketë siguruar pranë një shoqëri sigurimesh, që ushtron veprimtarinë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë prej 10 % të vlerës totale të Investimit të parashikuar. Formulari i Sigurimit të Kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkëlidhet kësaj Kontrate. Sigurimi i Kontratës do të zvogëlohet, me një përqindje të barabartë dhe *pro rata* me përqindjen e vlerës së Investimit të kryer për çdo Vepër të përfunduar. Me Përfundimin e Punimeve të Veprave dhe marrjen e Çertifikatës Përfundimtare, Koncesionari duhet të mbajë në fuqi një Sigurim Kontrate të barbartë me 2% (dy përqind) të Vlerës së Investimit, i cili duhet të jetë i vlefshëm deri në përfundim të Afatit të kësaj Kontrate

14.2. Koncesionari do të çngurtësojë vlerën e reduktuar të Sigurimit të Kontratës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga Përfundimi i Punimeve i cili vërtetohet dhe me firmosjen nga palët procesverbalit të Përfundit të Punimeve (Çertifikata Përfundimtare).

14.3. Në momentin që Koncesionari çngurtëson vlerën e reduktuar të Sigurimit të Kontratës, i lind detyrimi që të bëjë një sigurim të ri për fazën operacionale të Projektit në masën 2% të vlerës totale të Investimit.

14.4. Koncesionarit i lejohet të çngurtësojë këtë vlerën e përmendur në paragrafin 14.3. te këtij neni ketu, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të kësaj Kontrate..

15. SIGURIMET

15.1. Koncesionari në çdo kohë do të pajiset, mbajë dhe ripërtërije ato garanci sigurimi të kërkuara në lidhje me ushtrimin e të drejtave koncesionare dhe do t'i përcjellë, ose do të kujdeset që t'i përcillen Autoritetit Kontraktues kopjet e çertifikuara të çdo çertifikate sigurimi pas marrjes së një njoftimi paraprak prej Autoritetit Kontraktues.

15.2. Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit, apo gjatë Operimit të Impiantëve / Veprave vlera e dëmit e kompensuar nga siguruksi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të përdoret për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer Impiantin/Vepren në gjendjen që ishte para dëmtimit. Pjesa e zbritshme nga shuma që siguruksi do të paguajë për kompensimin e dëmit do të përballohet nga Koncesionari.

15.4. Koncesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.

15.5. Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200 000 Euro për çdo ngjarje dhe 500 000 Euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1000 Euro për çdo ngjarje dhe 2000 Euro në vit.

16. KUFIZIMET

16.1. Për çdo transferim të kapitalit themeltar të saj tek të tretët Koncesionari duhet të marrë pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktues. Në këtë rast palës se tretë do t'i transferohen dhe detyrimet apo të drejtat e përcaktuara në këtë Kontratë.

16.2. Koncesionari ka të drejtë të nënkontrakttojë detyrimet e tij për kryerje Punimesh sipas kësaj Kontratene perputhje me Ligjin per Koncesionet. Për mënjanimin e ndonjë keqkuptimi furnizuesit e pajisjeve, materialeve dhe/ose dërgesave nuk do të konsiderohen nën-kontraktorë sipas kësaj Kontrate.

16.3. Koncesionari në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate ka të drejtë të vendosë hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet e Veprave që do të krijohen në zbatim të Projektit dhe punimeve si dhe të lidhë çdo lloj marrëveshje financimi me çdo Palë Financuese / Huadhënësit, me kusht që hipoteka, pengu apo barra tjetër si dhe marrëveshja përkatëse e financimit t'i shërbejë përmbushjes së detyrimeve të Koncesionarit në këtë Kontratë.

17. FORCA MADHORE DHE VEPRIMI SHTETËROR THELBËSISHT NË KUNDËRSHTIM ME MARRËVESHJEN

17.1. Forca Madhore

17.1.1. Konsiderohen Ngjarje të Forcës Madhore, Ngjarjet që kane zgjatur jo me pak se 30 dite, si vijon:

- (a) Katastrofat e natyrës, zjarre, përmytjet, tërmetet, ngjarje nukleare, kimike biologjike, epidemi dhe çdo ngjarje e barabartë me to;
- (b) Lufta, lufta civile, gjendje të jashtëzakonshme, konflikte të armatosura, akte terroriste, bllokada, embargo, sabotazhe ose ngjarje të ngjashme, greva, bllokime, pasoja që rrjedhin nga ligje të reja, dhe ngjarje të ngjashme -;
- (c) Ngjarje të tjera të cilat mund të pengojnë fillimin ose perfundimin e Punimeve të Ndertimit apo t'i vonojnë ato, ose të pengojnë Operimin e Impianteve/Veprave dhe në teresi realizimin e Objektit të kësaj Kontrate dhe që janë përtej kontrollit të paleve

Në rastet e Forcës Madhore Pala e dëmtuar duhet të njoftojë Palën tjetër brenda 30 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e përmbushjes së detyrimeve në



mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.

17.1.2. Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore. Përvetse kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, kufijtë e përmbushjes së detyrimeve, do të përcaktohen nga Palët në marrëveshje ndërmjet tyre.

17.1.3. Periudha e Koncesionit do të zgjatet me aq kohë sa ka vazhduar Ngjarja e Forcës Madhore.

17.2. Zgjidhja e Kontratës për shkak të Forcës Madhore

Pala e prekur nga Forca Madhore ka të drejtë të zgjidhë Kontratën:

- (a) Në rast të një zgjidhje në të mirë të Projektit,
- (b) Në rastin e Forcës Madhore të Tejzgjatur.

17.3. Veprimi Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim Me Kontratën

17.3.1. Kur Koncesionari është penguar, pengohet ose vonohet në punën e tij, për shkak të Veprimit Shtetëror Thelbësisht Në Kundërshtim Me Kontratën, Koncesionari njofton Autoritetin Kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe bën të ditur:

- a) ekzistencën dhe natyrën e Veprimit Shtetëror Thelbësisht në Kundërshtim Me Kontratën;
- b) Efektet e këtij veprimi mbi punën e Koncesionarit;
- c) Hapat që Koncesionari ka ndërmarrë për të shmangur efektet negative të këtij veprimi në punën e Koncesionarit.

17.3.2. Autoriteti Kontraktues, me marrjen e njoftimit, ka të drejtë të kërkojë që Koncesionari t'i dorëzojë informacione shtesë dhe dëshmbështetëse.

17.3.3. Në qoftë se palët, nuk bien dakord në lidhje me ekzistencën ose efektet e Veprimit Shtetëror Thelbësisht Në Kundërshtim Me Kontratën brenda 60 ditëve nga njoftimi, secila palë ka të drejtë ta dërgojë çështjen në Gjykatën e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) në Paris.

17.3.4. Nëse bihet dakord se ka ndodhur Veprimi Shtetëror Thelbësisht Në Kundërshtim Me Kontratë dhe ka krijuar dëme, Koncesionari ka të drejtë të dëmshpërblehet dhe shtyrje të afateve nëse:

- a) Dëmet dhe vonesat janë rezultate direkte të Veprimit Shtetëror Thelbësisht Në Kundërshtim Me Kontratën
- b) Pasoja nuk mund të ishin shmangur me gjithë kujdesin e treguar nga Koncesionari për evitimin e tyre



18. ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE

18.1. Zgjidhje miqësore

Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese, që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë. Secila Palë njofton me shkrim Palën tjetër për ekzistencën e mosmarrëveshjes dhe Palët mblidhen për të arritur një zgjidhje brenda 30 ditëve nga njoftimi që ju është dhënë.

18.2. Gjykata kompetente

18.2.1. Në rast se Palët nuk janë në gjendje për të zgjidhur një mosmarrëveshje me përdorimin e procedurave të përcaktuara më lart, atëherë, secila palë ka të drejtë të kërkojë që mosmarrëveshje të tilla t'i drejtohen gjykatës kompetente për zgjidhjen e tyre, siç parashikohet më poshtë.

18.2.2. Kur një Palë dëshiron të drejtojë një çështje për gjykim në gjykatë në pajtim me kushtet e kësaj Kontrate, njofton me shkrim palën tjetër dhe mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC) në Paris (International Chamber of Commerce Paris) dhe vendi i arbitrazhit do të jetë Parisi, Francë. Trupa e Arbitrazhit do të përbëhet nga 3 (tre) arbitra, ku secila nga palët përzgjedh 1 (një) arbitër dhe i treti zgjidhet sipas Rregullave të Arbitrazhit. Rregullat e aplikueshme do të jenë Rregullat e Arbitrazhit të ICC Paris.

19. PENALITETET DHE DEMSHPERBLIMET

19.1. Mosrespektimi i afateve të Punimeve nga Data e Fillimit të Punimeve deri në Datën e Përfundimit të Punimeve, nga Koncesionari, për faj të Koncesionarit do të jetë subjekt penalitetesh nga Autoriteti Kontraktor, me kusht që Autoriteti Kontraktor të ketë përmbushur detyrimet e tij, që lidhen me respektimin e këtyre afatave. Penalitetet do të jenë si më poshtë vijon:

- a) 400 EUR/ditë vonese nga 60 deri në 90 ditë të periudhës vonese;
- b) 800 EUR/ditë vonese nga 90 deri në 120 ditë të periudhës vonese;
- c) 1250 Euro/ditë vonese nga 121 ditë në 180 të periudhës vonese;
- d) 2250 Euro/ditë vonese nga 181 ditë deri në 300 ditë.

Në çdo rast këto penalitete të marra së bashku nuk mund të kalojnë vlerën e 10 % (dhjetë përqind) të shumës totale të Investimit.

19.2 Vetëm në rast se Koncesionari ka realizuar më pak se 80% (tetëdhjetë) përqind të vlerës totale të Investimit, atëherë Koncesionari do të penalizohet për ti paguar Autoritetit Kontraktues një penalitet të barabartë me 5% (pesë përqind) të vlerës së përealizuar të Investimit.



19.3. Për çdo ditë vonesë për fillimin e punimeve nga Dita e planifikuar e Fillimit të Punimeve, ashtu sic definohet këtu nën këtë Kontratë, me kusht që Autoriteti Kontraktor të ketë përmbushur detyrimet e tij, dhe të ketë përfunduar plotësisht dhe pa të meta procesi i Shpronësimit dhe të jenë marrë në favor të Koncesionarit Lejet Zhvillimore, dhe të gjitha Autorizimet, Lejet / Licensat, Koncesionari do të penalizohet me një vlerë të barabartë prej 100 Euro në ditë.

19.4. Të gjitha penalitetet sipas këtij Neni ketu do të zbriten nga Sigurimi i Kontratës, deri në kufirin e vlerës së sigurimit, penalitetet që do të perbejnë vetmin penalitet për Koncesionarin sipas këtij neni ketu.

19.5. Sanksionet si me sipër nuk janë të aplikueshme, në rast se vonesat kanë ardhur si pasojë e rrethanave jashtë kontrollit të Koncesionarit.

19.7. Përtej pagesave në favor të Koncesionarit për Mos-përmbushje nga Autoriteti Kontraktor sipas parashikimeve të nenit 11.8.2, Autoriteti Kontraktor do të demshperblejë Koncesionarin për çdo Dëm Efektiv Humbje, dhe/ose Fitim të Munguar që ka ardhur si pasojë e:

- i. Dorëzimit të parregullt të sasise së Mbetjeve nga Njesite e Qeverisjes Vendore të Qarkut Tirane, për shkaqe që nuk lidhen me Koncesionarin;
- ii. Deshtimin nga Njesite e Qeverisjes Vendore të Qarkut Tirane të arrijnë sasine perkatëse të Mbetjeve që duhet t'i dorëzojnë Koncesionarit në përputhje me sasine e përcaktuar në mënyrë progresive në Planbiznes, pavaresisht arritjes së Sasise Minimale të Garantuar të Mbetjeve;
- iii. Vonesave që ka pësuar Projekti ose Koncesionari në realizimin e tij, e cila përfshin edhe pasojat që kanë ardhur prej këtyre vonesave, me përjashtim të shkaqeve që lidhen me Forcën Madhore ose Koncesionarin;
- iv. Çdo shkak tjetër të parashikuar nga Ligji.

20. VONESA TË KONCESIONARIT

20.1. Vonesa në Përfundimet Paraprake

Me përjashtim të rasteve të parashikuara në Kontratë (rrethana të veçanta gjatë fazës së ndërtimit – shtyrja e përfundimit të fazave të ndërtimit, etj.), nëse përfundimi i Veprave nuk kryhet brenda afateve të përcaktuara në Grafikon e Punimeve, përveç se për arsye që janë jashtë kontrollit të Koncesionarit, ky do t'i paguajë Autoritetit Kontraktues penalitetet sipas përcaktimeve në nenin 19.3 më sipër.

20.2. Vonesa e veprimeve korigjuese

Në qoftë se Koncesionari nuk ndërmerr gjitha veprimet e nevojshme korigjuese për të përmirësuar shkaqet e mospërmbushjes të vëna në dukje në njoftimin e Dështimit, brenda një kohe të arsyeshme, i paguan Autoritetit Kontraktues dëmet, në lidhje me



Impiantet, pas skadimit të një periudhe prej 60 dite pune, me pagesat përkatëse për çdo dite vonese.

20.2.1. Shuma totale e dëmeve të pagueshme sipas këtij neni nuk do të tejkalojë shumën e Sigurimit të Kontratës.

20.2.2. Palët bien dakord që të gjithë penalitetet e parashikuara për Koncesionarin do të zbatohen deri në një vlerë maksimale prej 10 % të Vlerës së Investimit. Penalitetet do të llogariten çdo fund viti kalendarik, sipas një akti rakordimi të përbashkët që bëhet ndërmjet palëve të kësaj Kontrate.

20.2.3. Sanksionet për Koncesionarin paguhen në llogari të Autoritetit Kontraktues. Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e penaliteteve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të diskutojnë për një periudhe 90 ditore lidhur me shkeljen.

20.2.4. Kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 90 dite. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.

21. RREGULLIMI I SHKELJEVE

21.1. Në çdo rast kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë periudhës së Koncesionit, Koncesionari ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë Kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Koncesionarit duke pritur për një periudhë 90 ditore përgjigjen e tij, me argumentet përkatëse. Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.

22. TRANSFERIMI I ASETETEVE DHE PERIUDHA KALIMTARE

22.1. Në gjashtë muajt e fundit të afatit, Koncesionari do të fillojë kryerjen e dorëzimit të detyrimeve të mëposhtme dhe do të bashkëpunojnë me Autoritetin Kontraktues, ose ndonjë palë e tretë të caktuar nga Autoriteti Kontraktues, për të dorëzuar Veprat:

22.2. Menjëherë pas mbarimit të Afatit:

- a. Veprat duhet të jenë në një gjendje të mirë, në përputhje me çdo regjim për mirëmbajtjen e planifikuar, të plotësojë kushtet normale teknike, që i nënshtrohen një zhvlerësimi të arsyeshëm.
- b. të drejtat e koncesionit automatikisht shuhet dhe Koncesionari nuk ka të drejtë të përdorin dhe të gëzojnë impiantin përkatës, kantieret dhe të drejtën e kalimit;
- c. Koncesionari, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë, , menjëherë i transferon tek Autoriteti Kontraktues, pa pagesë dhe pa barrë apo peng, në gjendjen "siç është", të gjitha të drejtat e koncesionarit, titujt dhe interesat që kanë lidhje me impiantin (duke



përfshirë edhe pronësinë e impianteve të tilla, (për aq sa ato janë pjesë e ose të përdoren në Projekt), si më poshtë:

- i. të gjitha lëndëve të para, konsumit dhe pjesë kembimi,
- ii. të gjitha pasurive të prekshme personale,
- iii. të gjitha pasuritë e paprekshme personale, duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale (që nuk janë transferuar tashmë me licencë),
- iv. të gjitha ndërtesat dhe mjetet,
- v. të dhënat e kompjuterizuara dhe jo-kompjuterizuar, raporte, të dhëna, fotografi, dhe informacion, skica, rezultatet e testit, dokumentet
- vi. të gjitha garancitë e materialeve, pajisjeve dhe punimeve
- vii. të gjitha të drejtat e kontratës duke përfshirë qiratë dhe policat e sigurimit,
- viii. të gjitha veprat në progres (duke përfshirë punimet e ndërtimit, nëse e zbatueshme) sipas kontratave me shitesit, furnizuesit, kontraktorët dhe nënkontraktorët.

23. PËRFUNDIMI I KONTRATES

23.1. Kontrata Koncesionare përfundon me përfundimin e Afatit 30 vjeçar të saj, përveç rasteve kur ka një zgjatje në afat, konform dispozitave të kësaj Kontrate.


23.2. Përfundimi i Kontratës si përfundim i afatit të saj ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.


24. KONFIDENCIALITETI

24.1. Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentet dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

24.2. Pavaresisht nga dispozitat e tjera, informacioni mund të jepet pa pëlqimin e palës tjetër:

- a) Entiteteve Shtetërore;
- b) nga koncesionari për Palët financuese;
- c) nga një Palë për drejtorët e saj, zyrtarët, punonjësit, agjentët dhe këshilltarët teknikë dhe profesionale dhe çdo bashkëpunëtor i kësaj pale, që në mënyrë të arsyeshme kërkojnë informacion të tillë gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive të tij në lidhje me këtë kontratë;



- 
- d) nga një Palë për kontraktorët e tij dhe furnizuesit deri në masën e arsyeshme për përmbushjen e detyrimeve të tyre;
 - e) nga një Palë, në masën e kërkuar, për qëllime të marrjes dhe ruajtjes e sigurimeve;
 - f) në masën e kërkuar nga ligji, autorizimet ose rregullat e ndonjë burse të njohur në të cilën aksionet e palës në fjalë, janë të kuotuar;
 - g) përqëllime të zgjidhjes së konflikteve ose zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve sipas kësaj Kontrate.

25. TË NDRYSHIME

25.1. Kjo Kontratë mund të pësojë ndryshime, shtesa dhe/ose zëvendësime për pjesët e negociuara të procedurës referuar legjislacionit në fuqi, vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve.

25.2. Çdo ndryshim i kësaj marrëveshje apo anekseve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

26. CAKTIMI – SIGURIA

26.1. Koncesionari nuk do të transferojë kuotat e tij, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues. Gjithsesi, Koncesionari ka të drejtë, në masën e lejuar nga Ligji dhe siç mund të kërkohej në Dokumentet e Financimit, të vendosë hipotekë ose të transferojë të drejtat e tij sipas kësaj Kontrate me qëllim të ofrimit të garancisë për Institucionet Financiare/Palet Financuese,

26.2. Çdo veprim për shitje, apo shitje të supozuar, shitje me barrë, caktimi apo transferimi i të drejtave apo detyrimeve ose interesave, nga Koncesionari tek të tretët, jo në përputhje me kushtet e këtij neni është nul, i pavlefshëm dhe pa efekt.

27. GJUHA

Kjo Marrëveshje do të ekzekutohet dhe zbatohet në gjuhën shqipe dhe të gjitha komunikimet dhe njoftimet ndërmjet Palëve do të jenë në gjuhën shqipe.

28. FOSILET DHE ANTIKE

28.1. Pa paragjykuar të drejtat e Koncesionarit për çdo shtyrje të përfundimit të fazave të ndërtimit, Koncesionari duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues dhe të ndërpresë Punimet në Sheshe, nëse zbulohen fosile apo antikave (në Sheshin apo rrethinat e tij).

28.2. Pas pranimit të njoftimit të Koncesionarit, Autoriteti Kontraktues do të informojë autoritetet kompetente shqiptare dhe të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të siguruar që ata nëmënyrë të shpejtë e të koordinuar të hulumtojnë fosilet ose antikave në lidhje me këto Sheshe.



28.3. Në rast se raporti i autoriteteve kompetente shqiptare tregon mundësinë e heqjes së antikave ose fosilet nga Sheshet, Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë të gjitha shpenzimet e heqjes së fosileve ose antikave.

28.4. Në rast se raporti me shkrim të autoriteteve kompetente shqiptare tregon se ndërtimi nuk mund të vazhdojë në Sheshin në të cilin fosilet apo antikatat u zbuluan, Autoriteti Kontraktues mund të vendosë t'i japë koncesionarit një Shesh tjetër me karakteristika të ngjashme në një kohë sa më shkurtër, dhe të ngrijë të gjitha afatet deri sa Koncesionari të vihet në të njëjtat kushte siç ishte përpara pezullimit të ndërtimit si më sipër.

28.5. Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë shpenzimet e transferimit të Punëve për zëvendësimin e Sheshit, me kusht, që Koncesionari të sigurojë gjithë ndihmën e arsyeshme për të ndihmuar Autoritetin Kontraktues të minimizojë kostot përkatëse dhe vonesat.

29. VLEFSHMËRIA E KËSAJ KONTRATE


Nëse ndonjë term apo dispozitë e kësaj kontrate rezulton e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk prek dispozitat e tjera. Në këtë rast dispozita e pavlefshme zëvendësohet nga dispozita përkatëse e ligjit ose nga një dispozitë tjetër, nëse Palët bien dakord. I njëjti kriter vlen edhe në rastin kur ka ndonjë mungesë të paqëllimshme në tekstin e kësaj kontrate.

30. KONTRATA E PLOTE

Kjo Kontratë, duke përfshirë edhe anekset bashkangjitur, përfaqëson të gjithë vullnetin e Palëve në lidhje me Projektin dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme ose të gjitha rregullimet, me gojë ose me shkrim, midis palëve në lidhje me Projektin.

31. PAMUNDËSIA E HEQJES DORË NGA KONTRATA

Asnjë dispozitë e kësaj Kontrate nuk bën të mundur tërheqjen e palëve nga Kontrata. Dështimi i secilës palë, për të përmbushur detyrimet e kësaj Kontrate nuk do të interpretohet asnjëherë si tërheqje nga Kontrata apo heqje dorë nga të drejtat apo detyrimet që rrjedhin nga ajo.




32. HYRJA NË FUQI E KONTRATËS SË KONCESIONIT

Kontrata e Koncesionit hartohet dhe nënshkruhet nga Palët përpara noterit në 6 (gjashtë) kopje në gjuhën shqipe, 2 për Koncesionarin dhe 4 për Autoritetin Kontraktor.

33. NJOFTIMET

33.1. Çdo njoftim ose komunikim tjetër ndërmjet Palëve do të jetë:



(i) i bërë në gjuhën shqipe

(ii) me shkrim,

(iii) i dorëzuar personalisht (dorazi) ose të dërguara me postë rekomande të parapaguar, dhe (iv) duhet të jetë shënuar për vëmëndjen e personit të caktuar më poshtë, ose të çdo personi që do të caktohet nga pala tjetër.

33.2. Çdo njoftim ose komunikim tjetër i bërë nga një palë për palën tjetër, në përputhje me dispozitat e mësipërme të këtij neni do të konsiderohet të jetë marrë nga Pala tjetër, nëse është dorëzuar dorazi në ditën që ajo është lënë në adresën e palës më poshtë (që mund të modifikohet nga koha në kohë pas njoftimit të arsyeshm nga secila Palë për Palën tjetër), nëse është dërguar nëpërmjet postës me parapagim, postë rekomande ose me korrier 48 (dyzet e tetë) orë nga data e postimit, ose nëse dërgohen me anë faksit, siç parashikohet më sipër.

Adresat që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj kontrate janë:

Për Autoritetin Kontraktues

Për Koncesionarin

Ministria e Mjedisit

"Integrated Energy BV SPV" Shpk

"Bulevardi Zhan D'Ark",

Rr. "Dervish Hima", H. 1,

Nr. 23, (Ish godina e ATSH), Tiranë

71/1

Tiranë – Shqipëri

Tiranë - Shqipëri

33.REGJISTRIMI I KONTRATËS

Brenda 30 ditëve nga Data Efektive, kjo Kontratë duhet të regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë Zyres Vendore të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

Kjo Kontratë u hartua në 6 (gjashtë) kopje, në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua nga palët në menyrë të rregullt, përpara meje Noterit dhe pasi iu lexua me zë të lartë dhe të qartëatyre, u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre, unë Noteri e vërtetoj atë sipas ligjit.

PALET

AUTORITETI KONTRAKTOR

KONCESIONARI

MINISTRIA E MJEDISIT

Integrated Energy BV SPV Sh.p.k.

Lefer KOKA

Giuseppe CIAFFAGLIONE

MINISTER

ADMINISTRATOR

NOTERI